# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7747 E diel 23 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)










Opinioni i Ditës

Nga SULEJMAN MATO

## Tritoli i fjalëve



Të flasësh sikur ke tritol në gojë, ose të flasësh për tritol duke menduar se fjalët me tritol në gojë të thëna në parlamentin shqiptar do nxitin të nesërmen ...

Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga SOKOL BALLA

## Emrat e ministrave që do largojë Rama dhe kush qëndron në qeveri



Vezët mbi të në parlament ditën e enjte duhet ta kenë bindur Edi Ramën sesa i vetmuar është këto kohë. Gjatë gjithë jetës një njeri me fat - dhe fati ...

Vijon në faqen 22

KESHILLI I LARTE I PROKURORISE DO TE HAPE PROCEDUREN E PERZGJEDHJES

# 4 EMRA, JA KANDIDATET PER PROKUROR TE PERGJITSHEM

Kryeprokurori i ardhshëm do ketë mandat 7-vjeçar pa të drejtë riemërimi. Gazetarja Klodiana Lala: Në garë, Arta Marku, Sokol Stojani, Adnan Xholi e Besnik Muçi









*(Në foto)* Arta Marku, Sokol Stojani, Adnan Xholi dhe Besnik Muçi

Në faqen 7



Kompensimi/ Emrat e përfituesve

## Pronarët që do të ndajnë 800 milionë lekë të reja nga fondi i ALUIZNI

Tokat e zëna nga "informalët", familjet që do marrin 6 mln euro në Tiranë, Elbasan, Vlorë

Këshilli i Ministrave ka miratuar pardje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Fshatra

Në faqet 8-10

KRYETARI I PD

## Apeli i Bashës: Duhet të ngrihemi, populli ta bëjë vetë vetingun

Në faqen 2

QARKULLIMI "CASH"

## Fundoset banda që transportoi 7 milionë paund, burg 3 shqiptarëve

Në faqen 6

AKUZA E OPOZITES

## PD: Devijimi i Lanës u bë për projektin 60 mln euro të Begos

Në faqen 4

OPERACIONI

## Festa e fundit të vitit, FNSH me plan kontrolli për të kërkuarit

Në faqen 5

KREU I QEVERISE



## Rama në Qytetin Studenti: Brenda mandatit do t'i ndreqim konviktet

Në faqen 3

MILOSAO Në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar

# Princi arbër që tregoi familjen Kastrioti

*Ben Andoni: A mund ta ndihë Kosova në kulturë Shqipërinë dhe anasjellas*

Nga ARISTOTEL MICI

Gjon Muzaka, i biri i despotit të principatës së Muzakajve, Gjin Muzaka, në vitin 1510 ka lënë me gjalljen e vet një gjenealogji të fisit të tij princëror. Vepra është e llojit të veçantë dhe e shkruar italisht në kushtet e



emigracionit. Kur Gjon Muzaka shkroi këtë "Memorie" ishte koha që po flitej për organizimin e një kryqëzate antiturke. Autori i saj ka pasur për qëllim kryesor t`u tregonte bijve të tij kufijtë e principatës, që po të ktheheshin rishtas në trojet e tyre pas ikjes së ...

Suplement

# PROTESTAT
## AKUZAT

Protesta, banorët-deputetëve: Rama një kufomë politike, t'ju vijë turp që ngritët kartonin

# Basha, apel shqiptarëve: Të ngrihemi, ta bëjmë vetë vetingun

## "Ata që votuan kundër, bashkëpunëtorë të krimit"

Valentina Madani

Banorët e Unazës së Re u mblodhën sërish mbrëmjen e djeshme në protestë, duke kërkuar anulimin e projektit korruptiv që po mundëson shembjen e banesave të tyre. Duke folur edhe për ligjin që u ul taksat të pasurve, banorët u kërkuan llogari deputetëve të mazhorancës se përse votuan një ligj që varfëron shqiptarët dhe pasuron oligarkët. "Si nuk ju vjen turp që ngritët kartonin për një kufomë politike?! Ai i ka ditët e numëruara politikisht, por ju ende nuk e kuptoni", u shprehën banorët. Ndërkohë, ata bënë thirrje edhe për lirimin e banorëve që po mbahen ende në burg. Në ditën e 49 të protestës, banorët e Unazës së Re thirrën: "Lironi çunat dhe burgosni Qendron dhe Gjiknurin", "Projekti i Unazës së Re, përgjegjës pse nuk ka". Banorët bënë të qartë se nuk kanë ndërmend të tërhiqen nga kauza e tyre deri në fitoren e plotë. Në mbështetje të tyre kanë shkuar edhe kreu i PD, Lulzim Basha si dhe deputetë e opozitës.

**AKUZAT**

Nga protesta e banorëve të Unazës së Re, kreu i opozitës, Lulzim Basha, akuzoi se ata që votuan kundër vetingut të politikanëve janë bashkëpunëtorë të krimit. Ndaj Basha u bëri thirrje të gjithë shqiptarëve që të ngrihen dhe të rezistojnë fuqishëm, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet tani që u rrëzua me forcën e kartonit, vetingu në politikë. "Çlirimi i politikës nga politikanë të lidhur me krimin dhe politikanë që justifikojnë pasurinë e tyre është domosdoshmëri. Unë e di që shumica e shqiptarëve e mbështet këtë. Shumica e shqiptarëve kanë kërkuar një zgjedhje për këtë. Dje politikanët me integritet patën rastin ta votonin, por siç e patë, në Kuvendin e Shqipërisë nuk ngriti kartonët një shumicë që përfaqëson popullin, por një pakicë që zhvat, vjedh dhe grabit popullin. Kjo është domethënia e votimit se fundmi në Kuvend. Të premten ka ndodhur vetingu i vërtetë i politikanëve. Të gjithë ata që kanë ngritur kartonët kundër ligjit të vetingut të politikanëve kanë dalë hapur si bashkëpunëtorë të krimit dhe vjedhjes", deklaroi z.Basha. Duke përsëritur mbështetjen për protestën e studentëve dhe protestave të tjera, kreu i demokratëve u bëri thirrje qytetarëve për qëndresë dhe rezistencë. "Në emër të opozitës ju bëj thirrje, ne kemi nevojë për ndihmën tuaj, që ndryshimin që kjo klikë e korruptuar, që kjo klikë e votoi kundër ta imponojmë me forcën e rezistencës dhe qëndresës qytetare", deklaroi kreu i PD-së. Më tej, Basha përmendi: "Ditët e fundit PD ka denoncuar një tjetër aferë, sot të gjithë e keni parë se si me dokumente zyrtare është faktuar mashtrimi i Erjon Veliajt, i cili firmosi devijimin e Lanës për të mos prekur pronën e Edmond Begos, i cili është firmosur edhe nga Rama. Çifti më i korruptuar Rama-Veliaj kanë bërë një akt që nuk është bërë mbi 2 mijë vjet në histori, kanë devijuar Ramën që të ndërtojë një kriminel. Të gjitha këto shkelje flagrante të ligjit bëhen për të favorizuar oligarkë dhe kriminelë. Nuk ka asnjë projekt zhvillimi për Shqipërinë".



Kreu i PD-së, Lulzim Basha. mbrëmë me banorët e "Astirit"

**THIRRJA**

"Ne mbështesim protestën e shqiptarëve. Sot iu bëj thirrje qytetarëve se ne kemi nevojë për ndihmën tuaj që këtë klikë të korruptuar e të lidhur me krimin, që këtë klikë që votoi kundër ta imponojmë me forcën e rezistencës qytetare", tha Basha.

**SALI BERISHA**

Ish-kryeministri Berisha publikoi dje një foto ku shihet Gjiknuri dhe Qendro teksa janë ulur në një kafe, ndërsa i ironizon. "Dami me Qendron në kafe klandestine, por në kohë reale: Vodhëm, por na kapën me presh në dorë! Si t'ia bëjmë?!", shkruan Berisha.



Protesta e banorëve të Unazës së Re

## "Askush s'përfitoi nga detyrat e mia publike"

# Akuzat e Veliajt, Tabaku: Është kapur në flagrancë me krimin

Deputetja e PD-së, Jori da Tabaku e ftuar dje në "Kjo Javë", në "News 24" komentoi akuzat e kryebashkiakut Veliaj në Këshillin Bashkiak, duke i kujtuar atij se është kapur në flagrancë me krimin. "Në fakt, nuk më bëjnë absolutisht asgjë, unë mërzitem dhe shqetësohem për familjarët dhe të njohurit e mi, që përfliten pa të drejtë në këtë mes. Për sa kohë që jam përfshirë në Bashkinë e Tiranës, por edhe në çdo funksion tjetër publik, nuk kam pasur asnjëherë absolutisht asnjë vendimmarrje në favor tim, apo të familjarëve të mi. Në fakt, këtë e them me krenari që vij nga dy familje të mëdha tiranase, Turdiu dhe Tabaku dhe kjo nuk është turp të thuash që vjen nga dy familje të mëdha ish-pronare, që ndoshta jo të gjithë i kanë gëzuar, por kurrë askush nuk ka përfituar asgjë si rezultat i funksionit dhe i detyrave të mia publike".




Në vijim, deputetja demokrate u shpreh se personalisht nuk është shqetësuar nga akuzat e kryebashkiakut, por rezervon një ndjesë për këdo që është përmendur pa të drejtë. "Për 50 vite Enver Hoxha i çoi nëpër burgje, u vodhi pronat, për 10-12 vite Edi Rama nuk i la që të zhvillonin pronat, ndërkohë që dje kanë qenë në shtëpitë e tyre, të afërm të mi të largët dhe kanë dëgjuar të jenë përgojuar. Mua thjesht më vjen keq për ta dhe për prindërit e mi që mund të jenë shqetësuar, por Erjon Veliaj ka qenë 4 vite në Bashkinë e Tiranës, nëse do kishte diçka për mua, do ta kishte thënë me kohë", - theksoi zj.Tabaku.

## Bylykbashi: Kushtetuesja, si legjenda e Doruntinës

Deputeti i PD-së, Oerd Bylikbashi, reagoi dje për situatën në të cilën ndodhet Gjykata Kushtetuese. Ai shkruan në "Facebook" për gjendjen e rëndë ku ndodhet ky institucion, duke shtuar se tetë anëtarë u larguan për shkak të vetingut dhe dorëheqjeve duke lënë këtë institucion vetëm me një anëtar. Bylykbashi bën paralelizëm me legjendën "Kostandini dhe Doruntina", ku vëllezërit e kësaj të fundit vdiqën nga lufta dhe mortaja. "Legjenda e Kushtetueses dhe Doruntinës. Kjo puna e Gjykatës Kushtetuese ka kapur dimensionin e legjendës. E kemi të shkruar në Kushtetutë, por nuk ekziston në realitet, madje sot të duket se nuk ka ekzistuar fare, por është një përrallë. Fiks si legjenda e Doruntinës. Dikur ishin 9 anëtarë të një trupe. ?8 anëtarë ikën nga pensioni, dorëheqjet dhe vetingu, ashtu si vëllezërit e Doruntinës që vdiqën nga lufta dhe murtaja. Në fund mbeti një anëtare, që pa shpresë pret ta zëvendësojnë sepse i ka mbaruar mandati".

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Konviktet tek Inxhinieria, kryeministri nxjerr videon: Kushte optimale brenda marsit

# Rama, te Qyteti Studenti: Brenda mandatit, konviktet e transformuara

## "1 ndër 8 pikat e studentëve po zbatohet"

Kryeministri Edi Rama inspektoi dje punimet në konviktet e Inxhinierisë së Ndërtimit, ku 1080 studentë do të përfitojnë, sipas tij, kushte optimale jetese. Z.Rama u njoh nga afër me detaje nga punimet dhe çfarë do të ofrojë investimi i ri për të gjithë studentët që do të popullojnë këto godina. "Në kantierin e konvikteve të Inxhinierisë së Ndërtimit (Rezidencat A/B/C dhe D), ku falë marrëveshjes me qeverinë gjermane, 1080 studentë do të akomodohen në kushte optimale, brenda muajit mars", - shprehet z.Rama. Një përgjigje u dha edhe studentëve protestues dhe atyre, që sipas tij, u kanë shkruar kërkesat. "Atyre që e kanë shkruar pikën 1 të 8 kërkesave të studentëve, u them se plani ynë për përmirësimin e kushteve në konvikte ka nisur të zbatohet kohë më parë. Por, nga ana tjetër, kjo pikë e artikuluar së fundmi si një kërkesë e studentëve është një shtysë e nevojshme për të ecur më shpejt", - deklaroi z.Rama. Ky është projekti i Bankës Gjermane, që sipas Ramës, do të zhvillohet edhe në godina të tjera. "Janë kushte dhe standarde njësoj si në Gjermani, për shkak të programit të Bankës Gjermane për Zhvillim. Kjo do të jetë pararoja e standardeve dhe e gjithë transformimit. Ndërkohë që për godinat e tjera do të veprojmë më shpejt dhe me standarde dinjitoze dhe evropiane", deklaroi kryeministri. Po dje z.Rama shpërndau një video në "Facebook", teksa inspekton godinat e Qytetit të Studentit. Kreu i qeverisë njoftoi se ka filluar puna në 9 konvikte në Qytetin Studenti, por qeveria nuk do ndalet dhe të gjitha godinat në konviktet e tjera në vend do të marrin një pamjeje tjetër. "Me aktin normativ i kemi kaluar Bashkisë së Tiranës 3 milionë dollarë për të vazhduar me godina të tjera, por gjithashtu kemi dhe një grup tjetër konviktesh me KFW gjermane. Ambicia është që brenda mandatit të gjitha konviktet e Tiranës dhe Shqipërisë të vinë në stad tjetër. Me Bashkinë e Tiranës do vazhdojmë projektin e Kampusit Universitar, që sidoqoftë është një problem më vetë përsa i përket pronësisë. Kemi një situatë të rëndë me kthimin e pronave. E rëndësishme është që jemi shumë të qartë se çfarë duhet të bëjmë", theksoi z.Rama. Në statusin në "Facebook", kryeministri shprehet: "Në kantierin e konvikteve të Qytetit Studenti, ku njësoj si tek Inxhinieria, do të rindërtohen me themel 9 godina falë marrëveshjes me qeverinë gjermane; 3 godina do të bëhen me ndihmën e parë të qeverisë turke, që do të pasohet nga një e dytë vitin e ardhshëm; Bashkia e Tiranës po ashtu, do të çelë së shpejti kantierin e disa godinave të tjera, me financimin e sapoakorduar nga qeveria shqiptare prej 3mln USD. Paralelisht po punohet për projektin e Kampusit Universitar dhe do të nisë këtë javë evidentimi i ndërtimeve pa leje brenda territorit të Qytetit Studenti".



Kryeminisri Edi Rama gjatë inspektimit të konvikteve të Inxhinierisë

**TRITAN SHEHU**

"Krejt bosh ky 'qytet' simbol këto ditë, vetëm kryeministri e shoqëruesit e tij. Siç duket ka frikë ta pësojë aty si Adil Çarçani me 1990-tën. Mbasi mori në universitete të ndryshme mesazhe të ngjashme me ato që morën Muho Asllani, Lenka Çuko etj., në ato vite, vjen në këtë 'Qytet', por vetëm me një kusht, të ishte pa studentë!", tha Shehu.

"S'ka festa, mobilizim për largimin e kryeministrit"

## Kryemadhi, Ramës: Nuk ishe te konviktet, e vërteta e projektit tek Inxhinieria

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, pak pasi kryeministri Rama publikoi videon 'live' nga inspektimi në punimet që po bëhen në konviktet e Inxhinierisë, nxori zbuluar atë që ajo e quajti 'mashtrimin e Ramës'. Teksa Rama pasqyronte 'live' në televizione dhe në faqen e tij në "Facebook" vizitën e tij tek godina e studentëve të Inxhinierisë së Ndërtimit, Kryemadhi shkoi vetë menjëherë tek këto godina. Ajo bëri të ditur se Rama në të vërtetë nuk ndodhej 'live', por ekipi i tij i propagandës po transmetonte një kronikë të regjistruar më parë. Kryemadhi theksoi se kryeministri duhej të ishte te këto godina ditët kur studentët ishin aty dhe jo kur ata janë kthyer tashmë pranë familjeve të tyre.



Kryetarja e LSI denoncoi kryeministrin Rama gjithashtu se po mashtronte shqiptarët, kur thoshte që investimet për rikonstruksionin e këtyre godinave janë të qeverisë shqiptare. Ajo tha se në të vërtet ky është një mashtrim i madh, pasi bëhet fjalë për një projekt të nisur në vitin 2011 dhe që financohet nga qeveria gjermane. "E para njëherë, ai shpërndan një video ku thotë që investimi është projekti i qeverisë shqiptare, gënjen. Ja ku është tabela, që nuk është projekti i qeverisë shqiptare, por është projekti i qeverisë gjermane. Mbasi falsifikoi firmën e Sekretarit të Shtetit në Amerikë, tashmë po vjedh edhe projektet e qeverisë gjermane. Ky është projekt i vitit 2011 dhe duhet të kishte mbaruar në 20 dhjetor të 2018 dhe akoma nuk ka mbaruar. Por nuk mjafton kjo, por vjen edhe bën 'show' mediatik për të treguar që po mbaron sa më shpejt", deklaroi ajo. Kryemadhi u bëri thirrje strukturave të LSI-së që të mobilizohen edhe gjatë festave për të sensibilizuar qytetarët për rrëzimin e Ramës.

SHKURT

### "Dhurata" e studentëve për Ramën, ia mbushin bredhin me kartolina

Edhe pse numri më i madh i studentëve janë larguar nga kryeqytetit për t'u rikthyer në janar, para Kryeministrisë vijon protesta nga një grup studentësh. Disa prej tyre paraditja e djeshme i gjeti para godinës së Kryeministrisë, teksa vendosën kartolina me kërkesat e tyre në bredhin para ndërtesës, si një "dhuratë" për Ramën. Studentët i dërguan kryeministrit Rama kartolina me kërkesat tyre, duke uruar që t'i plotësojë ato. Të frymëzuar nga pema e Krishtlindjes para Kryeministrisë, një grup studentësh vendosën kartolina urimi, ku në to shkruhej secila prej kërkesave që kanë protestuar për 17 ditë me radhë. Madje, 8 kërkesave i është shtuar edhe 1 tjetër për personat me aftësi të kufizuar, ku kërkohet përjashtimi i tyre nga tarifa. Pavarësisht se studentët kanë vendosur që në janar do t'i rikthehen protestës nëse nuk do të plotësohen kushtet e tyre, një grup prej tyre ka vendosur që çdo ditë të protestojë para Kryeministrisë për rreth 2 orë. Bëhet fjalë pikërisht për kërkesat që studentët i kanë adresuar tashmë prej dy javësh kryeministrit e për të cilat, sikundër ritheksojnë, kërkojnë plotësim pa kushte e pa dialog.

### Më 28 dhjetor, shqiptarët e diasporës protestë para Kryeministrisë

Dhjetori është pagëzuar si muaj i protestave, kjo marrë shkas nga tubimi për më shumë se 16 ditë i studentëve, por dhe grupeve të tjera sociale. Por, përtej studentëve, të cilët ndoshta morën më shumë mbështetje se çdo protestë tjetër pas rrëzimit të diktaturës, është interesante protesta e emigrantëve e thirrur në fundvit. Në 28 dhjetor shumë emigrantë, të cilët vijnë në Shqipëri jo vetëm për pushime, do të protestojnë para Kryeministrisë. Genc Sejko, i njohur si "njeriu i memeve" është ideatori i protestës, e cila po merr mbështetje kryesisht në rrjetet sociale. "Ne si shqiptarë të diasporës i kemi dhënë qëllim vetes të mbështesim kauzat e drejta të shqiptarëve në Shqipëri, si të studentëve, banorëve të 'Astirit', minatorëve, invalidëve", informon Genc Sejko. Emigrantët nga Shtetet e Bashkuara, Anglia, Italia, Gjermania e shumë vende të tjera evropiane dhe në kontinente të ndryshme kanë konfirmuar pjesëmarrjen në protestë. Por përtej frymës antikonformiste dhe zgjimit të ndërgjegjes kryesisht të të rinjve për të ndryshuar realitetin, protestat edhe pse gjetën mbështetjen e qytetarëve, për njohësit e komunikimit, sërish pritshmëritë janë larg.

PD nxjerr dokumentet: Kryebashkiaku miratoi fazën e parë të pajisjes me leje ndërtimi për Begon

# PD: Devijimi i Lanës, Veliaj miratoi projektin 60 mln euro të Begos

## "Në 3 vjet ndryshoi strukturën e Tiranës"

Valentina Madani

Partia Demokratike denoncoi sërish dje atë që e quan afera korruptive në Unazën e Re. Demokratët Gazmend Bardhi dhe Ina Zhupa publikuan dje të tjera dokumente për miratimin që Bashkia e Tiranës i ka bërë fazës së parë të pajisjes me leje ndërtimi për projektin 60 milionë euro, që sipas PD-së, ndryshoi Planin Urbanistik dhe projektin e Lanës. "Erion Veliaj e mashtroi. Bashkia e Tiranës ka miratuar fazën e parë të pajisjes me leje ndërtimi për projektin 60 milionë euro, që ndryshoi Planin Urbanistik dhe projektin e Lanës", - shprehen ata duke nxjerrë një video, që sipas tyre provon miratimin e fazës së parë së projektit është autentik, i marrë nga sistemi elektronik i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Këshilltari ligjor Gazmend Bardhi theksoi se kryebashkiaku Erion Veliaj ka mashtruar, ndërsa sipas tij, Bashkia e Tiranës ka miratuar fazën e parë të pajisjes me leje ndërtimi për projektin 60 milionë euro, që ndryshoi Planin Urbanistik dhe projektin e Lanës. "Siç mashtroi qytetarët e Tiranës se gjatë mandatit të tij do të kishte zero ndërtime në kryeqytetet, njësoj po mashtron edhe sot Erion Veliaj se nuk ekziston projekti 60 milionë euro, i cili e detyroi kryetarin e Bashkisë së Tiranës të ndryshojë Planin Urbanistik dhe projektin për Lumin e Lanës", deklaroi këshilltari për çështjet ligjore në PD. Sipas Bardhit, "mashtrimi, propaganda dhe presioni ndaj mediave nuk e mbulojnë dot të vërtetën se Plani Urbanistik i Tiranës dhe projekti i Lanës u ndryshua me firmat e çiftit më të korruptuar të politikanëve në Europë, Edi Rama dhe Erion Veliaj". Partia Demokratike publikoi një material video, i marrë nga sistemi elektronik i Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që sipas saj provon miratimin e fazës së parë së projektit është autentik. "Në sistem prona që detyroi Edi Ramën dhe Erion Veliajn të ndryshojnë Planin Urbanistik të Tiranës dhe projektin për Lumin Lanë pranë zonës së Unazës së Re rezulton se ka kaluar fazën e parë të pajisjes me leje ndërtimi. Pas miratimit të fazës së parë, pajisja me leje ndërtimi e projektit 60 milionë euro që devijoi lumen e Lanës është vetëm formalitet. Erion Veliaj nuk mund ta mbulojë këtë të vërtetë me asnjë mashtrim, propagandë apo me blerje mediash. Sistemi nxjerr zbuluar mashtrimin e Erion Veliajt se gjoja në atë truall nuk ka asnjë projekt për ndërtim pallatesh. Kjo është arsyeja e vërtetë pse ai hesht dhe nuk u shpjegon qytetarëve të Tiranës pse ndryshoi Planin Urbanistik të Tiranës dhe rrjedhën e Lumit Lana", shprehet zj.Zhupa. Nisur nga kjo, zëdhënësja e PD-së, ngriti disa pyetje: "Pse u ndryshua Plani Urbanistik i Tiranës dhe pse u devijua Lumi i Lanës në zonën ku planifikon të ndërtojë Edmond Bego? A ka aplikuar Edmond Bego për leje ndërtimi me projektin e hartuar nga kompania italiane 'MISALAB'? A do të prishen banesat e 200 familjeve për t'i hapur rrugë ndërtimit të pallateve nga Edmond Bego? Paratë e kujt do të investohen në projektin që ndryshoi rrjedhën e Lanës". PD bën të ditur se në 3 vjet Erion Veliaj ka ndryshuar strukturën e të gjithë qytetit që t'i përshtatet projektit politik të Edi Ramës për shndërrimin e Tiranës në një lavatriçe të pastrimit të parave të pista.



Këshilltari ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi dhe zëdhënësja Ina Zhupa

**GAZMEND BARDHI**

"Siç mashtroi qytetarët e Tiranës se gjatë mandatit të tij do të kishte zero ndërtime në kryeqytetet, njësoj po mashtron edhe sot Erion Veliaj se nuk ekziston projekti 60 milionë euro, i cili e detyroi Veliajn të ndryshojë Planin Urbanistik dhe projektin për Lumin e Lanës", tha z.Bardhi.

**INA ZHUPA**

"Pse u ndryshua Plani Urbanistik i Tiranës dhe pse u devijua lumi i Lanës në zonën ku planifikon të ndërtojë Bego? A ka aplikuar Bego për leje ndërtimi me projektin e hartuar nga kompania italiane 'MISALAB'? A do të prishen banesat e 200 familjeve për t'i hapur rrugë ndërtimit të pallateve nga Bego"?

SHKURT

### "Taksat", Vokshi: Shqiptarët në varfëri, Rama u fal miliarda euro oligarkëve



Deputetja e PD-së, Albana Vokshi reagoi dje pas miratimit në fshehtësi të ligjit të miratuar një ditë më parë nga deputetët e mazhorancës, i cili ul taksat për oligarkët. Vokshi shkruan në "Facebook" se ligji i miratuar në fshehtësi shkel çdo procedurë ligjore dhe është një ligj skandaloz, i cili u jep oligarkëve qindra milionë euro. "Me këtë ulje oligarkët e Edi Ramës do të fitojnë të paktën 50 milionë euro në vit. Sikur të mos mjaftonte kaq, Edi Rama i dha ligjit fuqi prapavepruese: tatimi i përgjysmuar do të zbatohet edhe për fitimet e viteve të shkuara, të cilat nuk janë shpërndarë ende. Ky është një skandal që do t'u japë oligarkëve në total qindra milionë euro në xhep vetëm nga fitimet deri në vitin 2018", tha Vokshi. Sipas saj, Rilindja dhe Edi Rama që prej ditës së parë në pushtet kanë sjellë vetëm varfëri. "Kjo qeveri jeton në botën e luksit, ndërkohë që mbi 500 mijë familje jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme. 200 mijë fëmijë hanë më pak se tri vakte në ditë, 133 mijë nxënës e studentë kanë braktisur shkollat për arsye ekonomike, varfërie dhe emigrimi. 23 mijë nxënës ekselentë e të talentuar janë larguar në universitetet më të mira në botë, sepse nuk përballonin dot tarifat në universitetet shqiptare; 34 mijë mësuesve nuk u jepet shpërblimi i parashikuar në kontratën e punës. Edi Rama = varfëri për shqiptarët", shprehet deputetja e PD-së.

### Ligji për taksat, Vasili: Rama shkeli premtimin, ligji favorizon oligarkët



Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, foli dje për rrëzimin e dekretit të presidentit nga mazhoranca, lidhur me tatimin e dividentit. Sipas Vasilit, futja e dekretit në rend të ditës është bërë në shkelje të plotë të procedurës parlamentare, duke bërë që me votën e mazhorancës të rrëzohet parlamenti e jo dekreti. Vasili u shpreh se për këtë do të mbajnë përgjegjësi ata që shkelën procedurën. Kreu i grupit të LSI-së tha se: "Dekreti i rrëzuar vërtetonte qartësisht se ligji është antikushtetues, pasi jep efekt prapaveprues. Kushtetuta e thotë se çdo ligj që hyn në fuqi ka efekt nga ai moment e në vijim, por ky ligj nuk është i tillë. Ka efekte prapavepruese".

### "O djem, rrëmbeni armët", Ndreu: Lajthitje e Berishës



Deputeti socialist i qarkut të Lezhës, Pjerin Ndreu, në një intervistë për "Politika Online", në "gsh.al", i cilëson deklaratat e ish-kryeministri Berisha në Kuvend "o djem, rrëmbeni armët..." si lajthitje dhe sipas tij, pushtetin e ka marrë dhe e ka mbajtur gjithmonë me dhunë. "Çfarë ka bërë gjë tjetër ai, ma thuaj pak... Ky vend që nga '92 kur erdhi zotëria në pushtet kishte të gjitha shanset, mund të ishte një hap me Slloveninë e Hungarinë. Për shkak të tij, ky vend ka ngelur edhe pas Maqedonisë. Unë këtë thirrje e marr si një lajthitje që ai e ka në ADN. Nuk mund të vijë në pushtet as të mbajë pushtetin me rregulla. Kurrë nuk e ka bërë këtë, ka ardhur në pushtet dhe e ka mbajtur me armë. Shteti kur ka qenë ai të vriste, edhe ne kemi probleme, por nuk kemi ngritur armët ndaj qytetarëve. Vërtet kemi probleme, nuk jemi në pritshmërinë që duhej, por nuk kemi vrarë", deklaroi Ndreu. Sipas tij, ky tension që po krijohet, vjen për shkak se duan të bllokojnë reformën në drejtësi. "Pse ka një tension. Reforma në drejtësi do luftojë korrupsionin. Është një projekt eksperimental që do aplikohet në Shqipëri. Është më e ashpra që aplikohet ndonjëherë në botë, ku do varet dhe eksportimi i saj në rajon"./GSH.al

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA nr. 1/358, e llojit "Truall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Aviacionit) me sipërfaqe të truallit 273 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200,2 m2, Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, e regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 18, datë 07.01.2011 pranë Z.V.R.P.P TIRANË, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

ÇMIMI **36.389.985,28** LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë **03.01.2018.**

**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

DOMINUS

**Njoftim Shitje ne Ankand**

**Shoqeria Permbarimore "Dominus"** Rruga "Sami frasheri"pll "Titan", kati trete Tirane. cel 0692055122
Shitje ne ankand e e dyte te pasurise:Tokë Arë, Nr.Pasurie 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vilë-Ballaj, Kavajë
Çmimi me të cilin fillon shitja e pasurisë në ankandin e dyte është 1.323.000 lekë (një miljon e treqind e njëzet e tre mijë)
**Ankandi do te zhvillohet ne daten 25.12.2018, ora 16.00.**

**Njoftim për shitje me ankand të dytë**

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenet 577, 568 të K.Pr.Civile ka shpallur shitjen me ankand të dytë për pasurin e paluajtshme të palës debitore Sh" Ekspers Beton Lezhe"sh.p.k etj .
" "Tokë Are" në Z K 1987 me numër pasurie 30/38 Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 me cmim fillestar prej 58.016 Euro
" "Tokë Are" në Z K 1987 me numër pasurie 40/56 Volumi 11 Faqe 92 , me sipërfaqe 1730 m2 me me cmim fillestar prej 100.368 Euro
" "Tokë Are" në Z K 1987 me numër pasurie 25/73 Volumi 15 Faqe 239 , me sipërfaqe 2.000 m2 me cmim fillstar prej 98.112 Euro
Ankandi qëndron i hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 14.01.2019 ne orën 15:00, pranë selisë në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5 Ofertuesit mund te kontaktojnë 0672082543 dhe vizitojnë faqen WEB www.powerjustice-al.com.

## Të burgosurit e burgut 313, ankesë për prokurorinë e gjykatat, edhe avokatët bëhen palë me ta

**TIRANË** - Të burgosurit e burgut 313 përmes një letre kanë parashtruar një sërë ankesash drejtuar prokurorisë dhe gjykatave. Në ankesën e tyre, ata theksojnë se pritën vetingun për një drejtësi të drejtë, ndërsa shtojnë se edhe avokatët bëhen palë me gjykatat e prokurorinë. "Ankesa jonë e parë është për prokurorinë. Prokuroria po na akuzon me ambicie dhe bindje juridike. Edhe gjykatat mbështesin prokurorinë, edhe avokatët bëhen palë me gjykatat e prokurorinë. U bëjmë apel institucioneve më të larta të shtetit. Drejtësia e vetme për ne mbetet amnistia. Amnistia të jepet më shumë se tre vjet", thuhet në letrën e të burgosurve.



## Dosja "ÇEZ"/ Prokuroria e Tiranës merr letërporosinë nga Çekia



**TIRANË** - Prokuroria e Tiranës ka administruar ditën e djeshme letërporosinë e mbërritur nga Çekia në lidhje me dosjen "ÇEZ Shpërndarje". Në letërporosinë e autoriteteve çeke është dëshmia e dy ish-zyrtarëve çekë të kompanisë. Mësohet se në pyetje është marrë Josef Heisek, ish-drejtues, si edhe një tjetër zyrtar i ÇEZ, dëshmi të cilat do t'i shërbejnë hetimit. Gjykata vendosi zgjatjen e hetimet për dosjen "ÇEZ", me qëllim marrjen në pyetje të Nue Kalajt, i dyshuar si ndërmjetësi mes palës shqiptare dhe çekëve për privatizimin e kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike.

### Albert Dervishaj: Pritet që të ketë rritje të numrit të shtetasve që hyjnë në vend

# Festat e fundvitit, FNSH kontrolle në të gjithë vendin për kapjen e autorëve të ngjarjeve kriminale

## *Policia e Shtetit: Ja plani i masave për të rritur sigurinë e qytetarëve gjatë festimeve*

**TIRANË**

Me rastin e festave të fundvitit, Policia e Shtetit ka ndërmarrë një plan masash për të siguruar mbarëvajtjen e tyre. Albert Dervishaj, drejtor i Rendit Publik deklaroi dje se janë marrë një sërë masash shtesë, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt për qytetarët, pasi pritet të ketë rritje të numrit të shtetasve që hyjnë e dalin nga territori i republikës, rritje të numrit të mjeteve në qarkullim, zhvillim të aktiviteteve festive në sheshe, qendra dhe lokale etj. Gjithashtu, janë hartuar planet e vendosjes së shërbimeve të Policisë Rrugore, me qëllim monitorimin e akseve kryesore rrugore kombëtare. "Bazuar në informacione, do të organizohen shërbime të përbashkëta të këtyre strukturave dhe do të mbështeten edhe nga Repartet e Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, Fier, Shkodër për kontrollin e territorit dhe patrullime të përbashkëta, për qarkullimin e sigurt të automjeteve dhe kapjen e personave objekt i këtij kontrolli", ka deklaruar Dervishaj. Strukturat e policisë kanë planifikuar masa për mbajtjen në kontroll të situatës së sigurisë, në veçanti në sheshe publike, qendra tregtare që frekuentohen nga numër i madh qytetarësh, lokale dhe restorante, apo sheshe ku do të organizohen aktivitete festive etj. Në veçanti nga DVP Tiranë, gjatë natës së ndërrimit të viteve janë planifikuar punonjës policie në terren nga të cilët në Sheshin "Skënderbej", ku do të festohet nata e ndërrimit të viteve dhe ku Bashkia e Tiranës organizon koncertin festiv, siguria është organizuar në bashkëpunim me të gjitha institucionet që kanë detyrime. Ndërsa, nga ana e strukturave të Kufirit dhe të Migracionit vazhdojnë masat me shtimin e posteve të punës në Pikat e Kalimit Kufitar, me qëllim kryerjen e procedurave të shpejta dhe krijimin e lehtësirave gjatë hyrje-daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj. Janë evidentuar dhe organizuar shërbime në vende e objekte private, banka, zyra të këmbimit valutor, tregje, lokale dhe objekte ku administrohen vlera monetare e materiale, për të parandaluar ngjarje kriminale. Gjithashtu, strukturat e policisë do të organizojnë takime me subjektet e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike (SHPSF), për përforcimin e shërbimeve të sigurisë së objekteve, si dhe gjatë shoqërimit dhe transportimit të vlerave monetare. Ndërkaq, Policia e Shtetit në bashkëpunim me institucionet e tjera të Task Forcës së krijuar me urdhër të përbashkët të ministrit të Brendshëm, ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për ndalimin e hedhjes në treg të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve dhe përdorimin civil, që rrezikojnë sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e qytetarëve" dhe në zbatim të detyrimeve që përcaktohen, do të ushtrojnë kontrolle për verifikimin e kushteve të prodhimit, të magazinimit dhe të përdorimit nga subjektet e licencuara për lëndët piroteknike dhe fishekzjarrët. Po ashtu, strukturat e policisë do të analizojnë dhe rivlerësojnë informacionet për identifikimin e autorëve të ngjarjeve kriminale kundër jetës dhe pronës, konfliktet për motive të ndryshme, për personat në kërkim, si dhe do të organizojnë operacione për kapjen e tyre, duke angazhuar edhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë.



### MASAT E POLICISË SË SHTETIT

**1.** Rritja e sigurisë së komunitetit në të gjithë territorin.

**2.** Parandalimi i ngjarjeve kriminale, nëpërmjet kontrollit të plotë të territorit nga strukturat e Policisë.

**3.** Evidentimi dhe mbajtja nën kontroll e personave me precedentë kriminalë e penalë, i automjeteve që përdorin apo ambienteve që frekuentojnë.

**4.** Rritja e efikasitetit të shërbimeve të policisë në njohjen e situatës operative kriminale, nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëveprimit efektiv të strukturave.

**5.** Identifikimi dhe kapja e personave të ngjarjeve kriminale kundër jetës e pronës dhe personave në kërkim.

**6.** Sigurimi në kohë i informacioneve për parandalimin e ngjarjeve kriminale, planifikimi dhe zbatimi i masave për kapjen e autorëve të mundshëm dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore.

**7.** Rritjen e prezencës policore në akset kryesore rrugore, në funksion të parandalimit të aksidenteve rrugore dhe ngjarjeve kriminale.

**8.** Forcimi i masave për kontrollin ndaj subjekteve që tregtojnë fishekzjarrë duke bashkëpunuar me strukturat e tjera ligj zbatuese.



## Efektivja e Ina Nuka: Policia është ëndrra ime, kurrë s'do heq dorë

**TIRANË** - Ina Nuka, punonjësja e policisë që mbeti e plagosur nga një kapsollë gjatë protestës së 22 nëntorit para parlamentit, është kthyer mbrëmjen e së premtes në Tiranë. Ajo ka mbërritur në Rinas rreth orës 21:30, pas trajtimit mjekësor të specializuar në Ankara të Turqisë dhe ndërhyrjes që i bëri të mundur rikthimin e gishtit të këputur. "Policia është ëndrra ime, nuk do tërhiqem kurrë, ç'ka më ndodhi më ka bërë më të fortë, më të motivuar. Ndjehem e përulur para gjithë shqiptarëve, të cilët u bënë pjesë me mesazhet e tyre", tha Nuka pas mbërritjes në Rinas. Efektivja u prit nga zv.ministrja e Brendshme Romina Kuko, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu; drejtori i Departamentit për Sigurinë Gjovalin Loka; zv.drejtori për Rendin në DVP Tiranë, Dhimitraq Ziu, drejtues të tjerë të lartë të Policisë si dhe kolegë, miq e të afërm. Ina Nuka u shpreh se nuk ka mëri personale me askënd dhe për cilindo që shkel ligjin të veprojë ligji. "Mirënjohje e falënderim për gjithë shqiptarët që me mesazhet e tyre u solidarizuan dhe më mbështetën, ndjehem e përulur përpara tyre. Falënderoj kryeministrin e vendit, që bëri të mundur dërgimin tim në Turqi për ndërhyrje kirurgjikale shumë të specializuar, ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për inkurajimin dhe mbështetjen që më dhanë, kolegët dhe cilindo që u bë pjesë e dhimbjes sime. Falënderim i veçantë për mjekët e spitalit në Ankara, të cilët kryen tri operacione për të rikuperuar dëmtimin e madh të gishtave të dorës, si dhe qeverinë turke dhe ambasadorin e Shqipërisë në Turqi. Kurrë s'do heq dorë nga policia, pasi jam privuar nga shumë gjëra të tjera për të realizuar ëndrrën time, të jem pjesë e Policisë së Shtetit", tha ndër të tjera efektivja Ina Nuka.

Autoritetet britanike: "Kokat" e grupit kriminal, 2 vëllezërit Kolicaj

# "Fundoset" banda që transportoi 7 mln paund nga Anglia në Belgjikë, Greqi e Shqipëri

## *Gjykata dënon me 16.5 vite burg tre shqiptarët*

ANGLI

Tre shqiptarë në Angli, të cilët përmes 80 udhëtimeve ilegale me avion në Belgjikë, Greqi dhe Shqipëri transportuan 7 milionë sterlina që vinin me burime nga aktiviteti i paligjshëm janë dënuar nga një gjykatë angleze. Sipas mediave lokale të këtij vendi, të cilat citojnë autoritetet britanike, bëhet me dije se grupi kriminal që transportonte para cash në mënyrë ilegale jashtë Anglisë kryesohej nga dy vëllezërit shqiptarë Gjelosh dhe Jak Kolicaj, përkatësisht 37 dhe 47 vjeç. Drejtësia e shtetit anglez dënoi Jak Kolicajn me 8 vite burg, Gjelosh Kolicajn 6 vite burg dhe shqiptarin tjetër, Faton Syberi me 2 vite e 5 muaj burg. Agjencia Kombëtare e Krimit të Organizuar (NCA) pas hetimeve intensive zbuloi se tre shqiptarët kishin ndërmarrë 80 udhëtime ilegale, duke transportuar para cash përgjatë dy viteve, saktësisht nga nëntori 2016-janar 2018. Po sipas mediave angleze, dy vëllezërit Gjelosh Kolicaj dhe Jak Kolicaj transportonin korrierët e parave deri në aeroport, ndërsa prisnin deri sa të përfundonin procedurat e 'check'-in. Ky grup kishte rekrutuar shumë korrierë nga Rumania, të cilët pasi futeshin në grupin në fjalë, merrnin detyrat për të transportuar paratë nga Anglia në Shqipëri, Belgjikë dhe në Greqi. Sasia e parave fshihej nga ky grup në valixhe me shtresa të dyfishta si strategji për t'i shpëtuar identifikimit të tyre gjatë transportit. Mësohet se në shtator të vitit 2017, policia i kapi 180,000 paund Faton Syberit, ndërsa ai u përpoq të udhëtonte për në Selanik nga aeroporti i Stansted.









**DËNIMET PËR 3 SHQIPTARËT**

1. Jak Kolicaj, 8 vite burg
2. Gjelosh Kolicaj, 6 vite burg
3. Faton Syberi, 2.5 vite burg

Paratë ishin në valixhe ngjyrë kafe, të mbështjella me qese dhe brenda një tjetër valixheje të brendshme. Zyrtarë të NCA-së thanë për mediat angleze se të dënuarit kishin kryer disa udhëtime nga Anglia në drejtim të Shqipërisë duke sjellë shuma të mëdha financiare.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 *Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*":

**1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TE PARË PËR "SPECIALIST IT":**

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
c. Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
d. Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime ne fushen IT.
e. Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturat e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TE DYTË PËR "SPECIALIST IT":**

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
b. Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
c. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
d. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastukturën e rrjetit.
e. Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
f. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

**2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist Financë/Buxheti" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST FINANCË/BUXHETI":**

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
d. Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

**3. Shpall 1 (një) vend vakant për "Specialist i Burimeve Njerëzore" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT "SPECIALIST BURIME NJERËZORE":**

a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:**

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 20 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike,** nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

### Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të nisë javën e ardhshme procesin e përzgjedhjes së emrave

# 4 kandidatë për prokuror të përgjithshëm

## *Në garë Arta Marku, por edhe Sokol Stojani, Adnan Xholi e Besnik Muçi*

Vetëm pak ditë nga krijimi i këtij institucioni, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të hapë garën për kryeprokurorin e ri të përgjithshëm. Sipas ligjit, kryeprokurori propozohet nga KLP-ja dhe miratohet nga Kuvendi. Natyrshëm lind pyetja nëse do të rikandidojë zonja Arta Marku në këtë post? Cilët do të jenë kandidatët e tjerë që do të garojnë për postin e kryeprokurorit me një mandat 7-vjeçar? Gazetarja Klodiana Lala, e ftuar në emisionin "Kjo javë", në "News 24", duke iu referuar burimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, deklaroi se Marku do të kandidojë për këtë post, ndërsa shtoi se mund të mos jetë në krye të Prokurorisë së Përgjithshme. Po ashtu, ajo zbuloi edhe emra të tjerë kandidaturash.

**PJESË NGA DEKLARATA**

"Në mbledhjen e parë të KLP, ku ishte e pranishme edhe zonja Marku, e kemi pyetur atë dhe ajo preferoi që ta kalonte në heshtje. Burime pranë kabinetit të saj më kanë konfirmuar se ajo do të jetë ndër kandidatet e para që do të garojë për pozicionin e prokurores së përgjithshme me një mandat 7-vjeçar. Kanë filluar të përfliten edhe emrat e parë. KLP do ta hapë garën javën që vjen. Roli i prokurorit të përgjithshëm s'do të jetë roli që kishte dikur, por është një rol që do të duhet të ketë një njeri serioz. Edhe njëherë, nuk është se kam gjë personale me zonjën Marku, por mendoj se nuk e përfaqëson të gjithë trupën e prokurorëve, pasi nuk ka lidershipin për të pasur atë pozicion. U kritikua ashpër nga ndërkombëtarët. Zonja Marku nuk ka ndonjë bilanc apo ndonjë çështje që ngelet për t'u përmendur. Ka pasur profil të ulët dhe më është dukur, ku transferimet e prokurorëve duket sikur i ka bërë në shenjë hakmarrjeje. Më duket si një prokurore e kapur nga politika edhe për mënyrën se si veproi përgjatë qëndrimit të saj në këtë detyrë. Flitet që mund të konkurrojë Sokol Stojani, një prokuror me mjaft eksperiencë, që ka hetuar çështje të rëndësishme gjatë qëndrimit vite me radhë në Prokurorinë e Përgjithshme. Një figurë që u rikonfirmua nga KPK. Në garë është edhe Adnan Xholi, një tjetër prokuror me eksperiencë dhe që ka hetuar çështje të rëndësishme. Janë figura mjaft interesante, që kanë treguar në momente të caktuara forcën e duhur për të përballuar çështje të forta.

Pritet edhe kandidaturën e Besnik Muçit nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Ka qenë edhe më herët kandidat për prokurorin e përgjithshëm të përkohshëm, por u skualifikua për një kriter. Gara pritet të hapet, emrat mund të jenë nga më të ndryshimit. Të gjitha gjasat janë që zonja Marku jo vetëm që të rikandidojë, por edhe të jetë në krye të prokurorisë. Thelbi i gjithë kësaj është SPAK dhe këtu duhet vënë theksi. Se kush do të jetë njeriu që do drejtojë këto dy institucione të rëndësishme, pasi ata do të tregojnë peshën e vërtetë të reformës. Kam pikëpyetje të shumta edhe për vendimmarrjet e KPK".

**KESHILLI I PROKURORISE**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mbledhjen e parë në sallën e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka zgjedhur si kryetar Gent Ibrahimin dhe si zëvendëskryetar Alfred Ballën. Gent Ibrahimi vjen si kandidaturë nga bota akademike dhe nga pesë të zgjedhurit jomagjistratë, ndërsa Alfred Balla është përzgjedhur nga pesë anëtarët e votuar nga Shoqëria Civile.



**KANDIDATET PER KRYEPROKUROR**

1. Arta Marku
2. Adnan Xholi
3. Sokol Stojani
4. Besnik Muçi


Tirana International Airport

**TENDER NOTIFICATION**

**CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT**
**"AIRFIELD 2020" PROJECT**
**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked:
"CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

**Tirana International Airport sh.p.k**
**Administration Building**
**Rinas, Tirana**
**Albania**

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs.** on **11 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com


### Procesi nisi në gjykatat e rretheve gjyqësore Pukë, Berat dhe Korçë

## Pas vetingut, gjykatat e rretheve zgjedhin zëvendëskryetarët

Trupat gjyqësore e gjykatave të rrethit gjyqësor Pukë, Korçë dhe Berat u mblodhën të shtunën për të zgjedhur nënkryetarët e rinj për një mandat 1-vjeçar. "Është mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës, e cila zgjedh nga radhët e saj zëvendëskryetarin për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme, nëpërmjet një votimi, procedurë e cila është e mirëpërcaktuar në rregulloren e miratuar nga KLGJ", tha nëpërmjet një njoftimi për shtyp Këshilli i Lartë Gjyqësor. "Ky proces ka filluar në gjykatat e rretheve gjyqësore Pukë, Berat dhe Korçë, por do të pasojë menjëherë edhe në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit", shtoi KLGJ.



Kryetarët e gjykatës Pukës, Korçë dhe Berat u shkarkuan gjatë kësaj jave nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për shkelje të kriterit të pasurisë dhe papërshtatshmëri të figurës. Në mënyrë më specifike, kreu i gjykatës së Beratit, Agron Vavla u shkarkua pasi KPK i gjeti probleme me pasurinë. Komisioni gjeti probleme me pasurinë dhe pastërtinë e figurës për kreun e gjykatës së rrethit gjyqësor Korçë, Admir Belishta. Ndërkohë, kreu i gjykatës së Pukës, Izet Kadana u shkarkuar për probleme të konstatuara në të tre kriteret e vetingut. Me zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, sipas KLGJ-së merr zgjidhje edhe situata e krijuar pas shkarkimit të Kadanës, Belishtës dhe Vavlës. Sipas dispozitave ligjore në fuqi, në mungesë të kryetarit të gjykatës, kompetencat e tij i ushtron zëvendëskryetari.

KLGJ njoftoi të shtunën se zgjedhja e organeve drejtuese në gjykata do të jetë një përparësi e punës së tij, duke garantuar funksionimit të sistemit gjyqësor në vend.

Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## *ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj*

Këshilli i Ministrave ka miratuar pardje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

**AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE**
**LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT**

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| TIRANE VERI | | | | | | | | | |
| QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2679 | | | | | | | | | |
| | | | 1 | NADIRE | | PELLUMBI | | | |
| | | | 2 | EMINE | | PULAJ | | | |
| | | | 3 | MERJEM | | DURDA | | | |
| | | | 4 | LIRIJE | | DAKA | | | |
| | | | 5 | GJERAQIN | | SKENDERAGA | | | |
| | | | 6 | IRENA | | PELLUMBI | | | |
| | | | 7 | GENTI | | PELLUMBI | | | |
| ENVER | NEZIR | KADRIU | 8 | IRIS | | PELLUMBI | 229.1 | 4,242 | 971,842.20 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| HATMAN | ELEZ | KOJELI | 9 | HAXHI | | PELLUMBI | 434.2 | 2560 | 1,111,552.00 |
| MALIQ | MASAR | DOÇI | 10 | ZENEL | BAJRAM | DERVISHI | 262.8 | 2560 | 672,768.00 |
| | | | 11 | SHQIPONJA | | KUSI | | | |
| | | | 12 | DANJELA | | KUSI | | | |
| | | | 13 | GEZIM | | KUSI | | | |
| QEMAL | QAZIM | PANE | 14 | KEJSI | | KUSI | 227 | 2560 | 581,120.00 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| PELLUMB | SEFER | MAKSUTAJ | | | | | | | |
| QENAM | SEFER | MAKSUTAJ | | | | | | | |
| ERALDO | PELLUMB | MAKSUTAJ | | | | | | | |
| URAN | PELLUMB | MAKSUTAJ | | | | | | | |
| EURIAL | PELLUMB | MAKSUTAJ | 15 | SHKELQIM | AVDI | KOÇAJ | 340.4 | 4242 | 1,443,976.80 |
| AGIM | ENVER | RAMA | 16 | BARDHYL | SYRJA | KARALLIU | 276.00 | 4,242 | 1,170,792.00 |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 17 | ARBEN | GANI | LIKA | 44.00 | 4,242 | 186,648.00 |
| | | | 18 | ANILA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 19 | AIDA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 20 | MIRELA | | DIMROCI | | | |
| | | | 21 | SHKENDIE | | LLAGAMI | | | |
| | | | 22 | MELEQE | | LLAGAMI | | | |
| | | | 23 | QEMAL | | LLAGAMI | | | |
| | | | 24 | DASHURI | | LLAGAMI | | | |
| | | | 25 | DENIS | | LLAGAMI | | | |
| | | | 26 | HELIDON | | LLAGAMI | | | |
| | | | 27 | ETLEVA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 28 | BLEDAR | | LLAGAMI | | | |
| | | | 29 | FATBARDHA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 30 | DIANA | | DHAMO | | | |
| | | | 31 | AFERDITA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 32 | QAMIL | | PANARITI | | | |
| | | | 33 | BARDHYL | | LLAGAMI | | | |
| | | | 34 | DYLBERE | | LLAGAMI | | | |
| | | | 35 | BUJANA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 36 | DORIAN | | LLAGAMI | | | |
| | | | 37 | MIRANDA | | NOSI | | | |
| | | | 38 | MERITA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 39 | KLEJDA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 40 | DEA | | LLAGAMI | | | |
| | | | 41 | HAJDIE | | LLAGAMI | | | |
| | | | 42 | VIRIL | | LLAGAMI | | | |
| | | | 43 | DIVIN | | LLAGAMI | | | |
| | | | 44 | MIRADOR | | LLAGAMI | | | |
| | | | 45 | ENIDA | | LLAGAMI | | | |
| ELTON | SHAHIN | SHEHU | 46 | SHQIPE | | KOVACI | 124.00 | 4,242 | 526,008.00 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| | | | 47 | YLLI | ISUF | LULI | 117 | 479 | 56,043.00 |
| EQEREM | ADEM | SPAHIU | 48 | ILIR | HYSEN | DODA | 6.9 | 479 | 3,305.10 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8110, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| | | | 49 | ABDULLA | HAMIT | MYFIU | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 50 | AFERDITA | RAMAZAN | BASHA | | | |
| | | | 51 | AGIM | REXHEP | BASHA | | | |
| | | | 52 | AHMET | HAMIT | MYFTIU | | | |
| | | | 53 | AHMET | RAMAZAN | BASHA | | | |
| | | | 54 | EMINE | REXHEP | BASHA | | | |
| | | | 55 | ENGJELLUSHE | | KOKONOZI | | | |
| | | | 56 | EQEREM | HAJDAR | BASHA | | | |
| | | | 57 | FITNETE | SHAQIR | BASHA | | | |
| | | | 58 | GJYLE | SEFER | BASHA | | | |
| | | | 59 | HAMIT | | KOKONOZI | | | |
| | | | 60 | HATIXHE | HAMIT | KRETANI | | | |
| | | | 61 | ISMETE | HAMIT | MYRTERIZI | | | |
| | | | 62 | LAVDIE | | KOKONOZI | | | |
| | | | 63 | LEJLA | | KOKONOZI | | | |
| | | | 64 | LUAN | RAMAZAN | BASHA | | | |
| | | | 65 | LULJETA | | KOKONOZI | | | |
| | | | 66 | LULZIM | RAMAZAN | BASHA | | | |
| | | | 67 | MIMOZA | | KOKONOZI | | | |
| | | | 68 | MUHAMET | HAJDAR | BASHA | | | |
| | | | 69 | NAILE | RAMAZAN | BASHA | | | |
| | | | 70 | QEMAL | HAJDAR | BASHA | | | |
| | | | 71 | RIZA | | BASHA | | | |
| | | | 72 | SADIK | HAMIT | MYFTIU | | | |
| | | | 73 | SHQIPE | ZYBER | BASHA | | | |
| | | | 74 | SKENDER | REXHEP | BASHA | | | |
| ALFRED | DAJLAN | HABIBASI | 75 | YLBER | | KOKONOZI | 205 | 23703 | 4,859,115.00 |
| | | | 76 | BUJAR | | BEKA | | | |
| | | | 77 | FATIME | | BEKA | | | |
| | | | 78 | HASAN | | BEKA | | | |
| RIZA | QAMIL | HOXHA | 79 | HYSEN | | BEKA | 382.8 | 23703 | 9,073,508.40 |
| | | | 80 | BUJAR | | BEKA | | | |
| | | | 81 | FATIME | | BEKA | | | |
| | | | 82 | HASAN | | BEKA | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompenso h en | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 83 | HYSEN | | BEKA | 30.00 | 23,703 | 711,090.00 |
| | | | | | | | | | |
| | | | 84 | BUJAR | | BEKA | | | |
| | | | 85 | FATIME | | BEKA | | | |
| | | | 86 | HASAN | | BEKA | | | |
| | | | 87 | HYSEN | | BEKA | | | |
| GANI | MALIQ | HIDA | | | | | 470.00 | 23,703 | 11,140,410.00 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8120, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| PETRAQ | REFIK | BEGOLLI | 88 | ASTRIT | BARIQ | HAXHIU | 143.40 | 29,106 | 4,173,800.40 |
| | | | 89 | PETRIT | REXHEP | ÇUPI | 4.80 | 29,106 | 139,708.80 |
| BASHKIM | XHEMAL | TOTA | 90 | BUKURIE | MYSLIM | SARAÇ | | | |
| PAJTIM | RAMAZAN | ALMADHI | 91 | FATBARDHA | MYSLIM | MITA | | | |
| SABRI | XHEMAL | TOTA | 92 | ILIR | SHEFQET | KOKONOZI | | | |
| ZAIM | NAIM | HAMOLLI | 93 | JAKUP | MYSLIM | KOKONOZI | | | |
| | | | 94 | MYSLIM | | KOKONOZI | | | |
| | | | 95 | SULEJMAN | MYSLIM | KOKONOZI | | | |
| | | | 96 | VJOLLCA | RAMIZ | KOKONOZI | | | |
| | | | 97 | ZYRA | ZENEL | KOLLARI | 1161.4 | 29106 | 33,803,708.40 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 98 | AGIM | DAUT | TAFALLA | | | |
| | | | 99 | ANILA | FETA | TAFALLA | | | |
| | | | 100 | ARBEN | XHAVIT | TUFA | | | |
| | | | 101 | BASHKIM | DAUT | TAFALLA | | | |
| | | | 102 | DHURATA | XHAVIT | PERJA | | | |
| | | | 103 | ERMIRA | FERIT | OMERI | | | |
| | | | 104 | GANIMETE | FERIT | TOPRRA | | | |
| | | | 105 | GEZIM | FERIT | DULLA | | | |
| | | | 106 | ISLAM | DAUT | TAFALLA | | | |
| | | | 107 | JONUZ | XHAVIT | TUFA | | | |
| | | | 108 | RAJMONDA | FERID | DULLA | | | |
| | | | 109 | REBI | XHAVIT | TUFA | | | |
| NDRICIM | RESHIT | SALLAKU | 110 | REXHEP | DAUT | TAFALLA | 30.60 | 29,106 | 890,643.60 |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompenso h en | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 111 | DALIP | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 112 | ENVER | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 113 | LIRIFE | IBRAHIM | (VORPSI) TOPI | | | |
| | | | 114 | NAFIJE | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 115 | NEXHMIJE | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 116 | RAMAZAN | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 117 | SEMIHA | IBRAHIM | TOPI | 244.60 | 29,106 | 7,119,327.60 |
| | | | 118 | DALIP | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 119 | ENVER | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 120 | FATIME | REXHEP | TOPI | | | |
| | | | 121 | FATMIR | ALI | TOPI | | | |
| | | | 122 | GEZIM | ALI | TOPI | | | |
| | | | 123 | IFBALE | ALI | BAKALLI | | | |
| | | | 124 | LIRI | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 125 | MYRTEZA | DALIP | TOPI | | | |
| | | | 126 | NAFIJE | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 127 | NAILE | MUSA | TOPI | | | |
| | | | 128 | NEXHMIJE | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 129 | QANIE | ALI | GJOLEKA | | | |
| | | | 130 | RAMAZAN | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 131 | SEMIHA | IBRAHIM | TOPI | | | |
| | | | 132 | SHPRESA | ALI | PESJAKA | | | |
| MIRASH | ZEF | QOKAJ | 133 | SKENDER | ALI | TOPI | 3.10 | 29,106 | 90,228.60 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8140, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| | | | 134 | ALBINA | SABRI | SHASHAJ | | | |
| | | | 135 | BERIN | SABRI | SELENICA | | | |
| | | | 136 | GENC | HAMDI | SULCEBE | | | |
| ILIRJAN | AVDI | BREGU | 137 | MIRGJIND | SABRI | TEFIKU | 70.00 | 35,199 | 2,463,930.00 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| AGIM | SULEJMAN | SHEVROJA | 138 | MEHMET | | ILJAZI | 347.00 | 32,878 | 11,408,666.00 |
| | | | 139 | SULEJMAN | | ILJAZI | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| | | | 140 | BARDHYL | | MUMAJESI | | | |
| | | | 141 | MAKSIM | | MUJAMESI | | | |
| | | | 142 | MUBAREQ | | MUMAJESI | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompenso h en | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 143 | BAJRAM | | MUMAJESI | | | |
| | | | 144 | NAILE | | MUMAJESI | | | |
| | | | 145 | MIRTAN | | MUJAMESI | | | |
| | | | 146 | MILUKA | | MUMAJESI | | | |
| | | | 147 | EDMOND | | MUMAJESI | | | |
| | | | 148 | BUKURITE | | MOSHO | | | |
| | | | 149 | ELVITE | | VOGLI | | | |
| | | | 150 | BASHKIM | | ARBANA | | | |
| RAIMONDA | MERSIN | DERVISHI | 151 | ISLAM | | ARBANA | 36.10 | 31,270 | 1,128,847.00 |
| | | | 152 | MAKBULE | HAXHI | HUTA | | | |
| | | | 153 | MIMOZA | QEMAL | HUTA(BEQIRI) | | | |
| | | | 154 | ORNELA | QEMAL | HUTA(ORGOCKA) | | | |
| | | | 155 | YLLI | QEMAL | HUTA | 21 | 31270 | 656,670.00 |
| | | | 156 | AISHE | | TORA | | | |
| | | | 157 | FERID | | KERÇANI | | | |
| | | | 158 | HYSNI | | KERÇANI | | | |
| | | | 159 | LUMTURI | | MUÇA | | | |
| | | | 160 | QEFSERE | | AGO | | | |
| FIQIRI | LUTFI | TRUSHILLA | 161 | SHABAN | | KERÇANI | 26.4 | 31270 | 825,528.00 |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190, ZVRPP TIRANE | | | | | | | | | |
| MUHARREM | DEMIR | JOCA | 162 | AGIM | | MUCA | | | |
| ZEQIR | DEMIR | JOCA | 163 | BALLKIZ | | KUKA | | | |
| ARBEN | ELEZ | MUÇA | 164 | BASHKIM | | KUKA | | | |
| | | | 165 | FATBARDHA | | MUCA | | | |
| | | | 166 | FIQIRETE | | KUKA | | | |
| | | | 167 | FLUTURA | | KUKA | | | |
| | | | 168 | HAMID | | KUKA | | | |
| | | | 169 | ISMET | | KUKA | | | |
| | | | 170 | JEMINE | | VYSHKA | | | |
| | | | 171 | LIRIJE | | KUKA | | | |
| | | | 172 | LULEZIM | | MUCA | | | |
| | | | 173 | MYSLIM | | KUKA | | | |
| | | | 174 | MYSRET | | MUCA | | | |
| | | | 175 | RESHAT | | KUKA | | | |
| | | | 176 | REXHEP | | KUKA | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompenso h en | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 177 | SABRIJE | | KUKA | | | |
| | | | 178 | SADETE | | MUCA | | | |
| | | | 179 | SEIT | | KUKA | | | |
| | | | 180 | SEMIHA | | KUKA | | | |
| | | | 181 | SHAJE | | MARAJ | | | |
| | | | 182 | SHPRESA | | MUCA | | | |
| | | | 183 | SUZANA | | MUCA | | | |
| | | | 184 | AGRON | | MJOLLI | | | |
| | | | 185 | ANDONETA | | MJOLLI | | | |
| | | | 186 | ARBEN | | VYSHKA | | | |
| | | | 187 | ARTAN | | KUKA | | | |
| | | | 188 | BEDRI | | MJOLLI | | | |
| | | | 189 | BUJAR | | KUKA | | | |
| | | | 190 | FATBARDHA | | BYLYKBASHI | | | |
| | | | 191 | IKBALE | | KUKA | | | |
| | | | 192 | ILIR | | VYSHKA | | | |
| | | | 193 | IRAIDA | | MJOLLI | | | |
| | | | 194 | ISMAIL | | MJOLLI | | | |
| | | | 195 | KUME | | MJOLLI | | | |
| | | | 196 | LULJETA | | VYSHKA | | | |

LIBRI

# MIMOZA HAFIZI

# "Pika Trëndafil", ku gonxhja çel në yll

Nga Alfred Çapaliku

Romani shkencor është një lloj letrar miks ku relievi i epikës shtrihet mbi peizazhin e psikës. Veçoritë dalluese në sfondin e zhanrit të lëvruar me pasion nga autorja Mimoza Hafizi, përmblidhen te kryqëzimi i katër pikave të orientimit në horizontin e pritjes:

1. Në konstruktin e romanit "Pika Trëndafil" fjala e figurshme dhe argumentimi i saktë rendin nga Toka deri përtej Galaksisë, nëpër pistat paralele të artit dhe të shkencës.

2. Artefakti i veprës vizualiste për Ne dhe Alienët realizohet përmes miksazhit ndërdisiplinor.

3. Në kapitujt dhe nënndarjet e tyre prizmohet e mundshmja njerëzore, si fantazi në kufijtë e dijes.

4. Pikturat e Përvathit e të Verbicës, të ideuara nga Hafizi, shoqëruar me fotografitë sinops, flasin me gjuhën e ngjyrës. Në roman faqet tek (të veprimit) ndiqen nga ato çift (të shpjegimit); kësisoj tekstet me germa e me numra, me figura e me diagrame, shkrihen në një, duke synuar krijimin e megalibrit apo të librit total.

Subjekti i romanit fillon marsit të 1609-ës në Pragë, me astronomin Kepler, në të shkuarën e largët. Rrëfimi i fundit bëhet prillit të 2019-ës në Tiranë, me astrofizikanen Sara, në të ardhmen e afërt. Kështu loja me kohën e humbur të Marsel Prustit kombinohet me teorinë e relativitetit të Albert Ajnshtajnit.

Areali gjeografik i veprës nis nga selia e ESO-s (Europian Space Observatory) në Garching pranë Munich-ut - Gjermani, ngjitet në majën e Andeve te La Sille - Kili, shtrihet në operacionet e misionit yjor në Kolorado, Kaliforni, Baltimore - Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbërrin në auditorët e Universitetit të Tiranës - Shqipëri, duke ia lënë vendin arealit kozmik me buzëqeshje planetesh nga Helong-u në Frong, apo prej Pikës së kaltër te Pika Trëndafil, që i ngjan Tokës sonë.

Personazhet, si një kompleks që shoqëron harpën e gjashtëqind e dyzet e dy planeteve: Sara, Robert, Erik, Lurdes, Ema, Edvin, Daniel, Lorenco komunikojnë në distancë me njëri - tjetrin përmes tastierës së kompjuterit, me ritmin e zemrës. Ata ndjekin turnin e tretë: gdhihen në observatorë nën kupën qiellore, larg pluhurit ndotës e dritës artificiale të qyteteve, në kërkimin dhe kapjen e një sinjali …

Ata janë mbështetës të fuqishëm të njëri-tjetrit në strategjitë e imta profesionale dhe në projektet këmbëngulëse shumëvjeçare. Ata dhe stafi i tyre punojnë si ekip unik, si grup këmbëngulës, për gjetjen e planeteve të banueshme ndër tetëdhjetë e tetë pjesët e hartës së qiellit. Ata i tërheq mbirja e jetës në ekzoplanetet e galaksive fqinje, zbuluar nëpërmjet mikropërthyerjes së valëve gravitacionale me shpejtësi drite. Ata kanë detyrë të përhershme dhe qëllim të vazhdueshëm popullarizimin maksimal të shkencës së yjeve, përmes një gjuhë të kuptueshme qartë: Për gazetarët që bëjnë pyetje të zgjuara për konstelacionet duke shkaktuar jehonën e parashikuar masive; për lexuesit elitarë të revistave të ilustruara astronomike të NASA-s që kërkojnë verifikimin e artikujve të publikuar; për nxënësit e shkollave që vijnë për të parë aparaturat e sofistifikuara dhe për të luajtur pastaj mbi fushat me bar rreth ndërtesave me arkitekturë kozmike; për studentët që synojnë të marrin të dhënat skup nga universi prej ekraneve përherë të ndezura të monitorëve; për astrofilët, kuriozë të përjetshëm, që shohin pamjet e bukura spektografike; për ish-fansat e Armstrongut, të interesuar tashmë për eksplorimin e territ absolut e të mjegullnajave të tejhapësirës; për banorët e qytetit fqinj që e ndjejnë veten në qendrën studimore si në oborrin e shtëpisë; për prindërit që u venë fëmijëve emra me gjini yjesh; për vizitorët e çdo moshe që ndjekin imazhet e fundit të sjella nga teleskopi në zhdukje e sipër Kepler; për spektatorët e qiellit me sy të lirë a me tejqyra amatore që ngaanjëherë "konkurrojnë" me sukses të plotë, duke u bërë zbulues yjesh të harruar nga specialistët; për të huajt e ardhur që gjejnë atraksionin e radhës, ëndrrën trendi të turizmit ndërplanetar. Dhe e gjithë kjo ndodh se: "... njerëzve u pëlqen të jenë pjesë e punës së tjetrit", zbulon Prof. Mimoza Hafizi. Romanin e saj "Pika Trëndafil" e karakterizon gjendja e suspansës dhe e tensionit, mbasi në të shpresohet vazhdimisht të ndodhë diçka e rrallë e madhështore. Ndihet në ajër dhe pritet realisht që të shpallet zbulimi i një tjetër planeti të banuar, mbirja e jetës në një tjetër Galaksi, takimi surprizues me jashtëtokësorët. Disku i artë i nisur nga Toka me përshëndetjen e ngrohtë "Mirëdita!" dhe me sistemin shenjor për t'u deshifruar nga alienët, vazhdon rrotullimin. Çdo staf observatorësh dhe teleskopësh dëshiron të interceptojë i pari përgjigjen miqësore "Tung!" prej tyre.




*Romani ku pas tensionit pritet madhështorja, historia që nis në Pragë*

I lakmueshëm nga ana letrare si përshkrim dhe impresionues nga ana shkencore si sintetizim, në fund të romanit, spikat monologu i marrëdhënies së ngushtë e të pandashme të njeriut me kibernitikën në epokën e sotme moderne:

"Njerëzimi po i kërkon botët e ngjashme me Tokën e vet, si dhe alienët, që mund të kenë gjetur strehë në këto miliarda planete të galaksisë sonë... mendja fluturoi tek ai trup metalik me forma njerëzore, tek ai robot hapësinor, që kishte lënë truallin 41 vjet të shkuar e po çante me guxim errësirën e thellë përtej Sistemit Diellor. Sonda Hapësinore Voyager, pëshpëriti, makina trime po udhëheq destinacionin e njeriut". jo është kredoja e protagonistes Sara, me erë mimoze shqiptare!

## SKËNDERBEU NË LEÇE

Muzeu Historik Kombëtar, Polo Biblio-Museale e Provincës së Leçes dhe Muzeu Castromediano në Leçe të enjten, më 20 dhjetor 2018 çelën ekspozitën "Scanderbeg. Un eroe albanese in Puglia". Pas saj u mbajt konferenca për 550-vjetorin e vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Hapja e ekspozitës "Scanderbeg. Un eroe albanese in Puglia" është një mundësi e çmuar për të reflektuar mbi marrëdhëniet historike që Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu ka pasur me rajonin e Pulias dhe dukumentet unike që janë mbledhur nga pala italiane për këtë ekspozitë, të cilat na japin fakte të rëndësishme historikë për periudhën e Mesjetës. Muzeu Historik Kombëtar paraqit me objekte dhe libra kushtuar figurës së Heroit tonë Kombëtar si riprodhimi i Përkrenares dhe shpatës së Skënderbeut, si edhe armë të asaj periudhe. Kjo ekspozitë erdhi si frut i marrëveshjes ndërmjet Muzeut Historik Kombëtar, Museo Civico di Bari dhe Polo Bibliomuseale të Rajonit të Pulias nën kujdesin e Fondacionit Gramsci në Pulia, me qëllim që të fillohet promovimi i përbashkët i njohurive të iniciativave historike nëpërmjet përgatitjes së ekspozitave dhe promovimin e projekteve kërkimore, duke e imagjinuar Adriatikun jugor si një distrikt të vërtetë kulturor, në të cilin integrohen ndërmarrjet e nismave të përbashkëta të pranishme në territore të ndryshme, duke marrë pjesë së bashku me thirrjet evropiane. Viti 2018 ishte dhe Viti Mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, vendosur nga qeveria e Shqipërisë dhe për Muzeun Historik Kombëtar kjo ekspozitë është edhe aktiviteti përmbyllës në kuadër të këtij viti jubile për figurën e Skënderbeut. Ekspozita do të qëndrojë e hapur në datat 20 dhjetor-03 shkurt 2019 në ambientet e Muzeut Castromediano të Leçes.




## ROALD DAHL ME "ÇARLI DHE ASHENSORI I MADH PREJ XHAMI"

Këtë herë Roald Dahl vjen në shqip në një format të madh krejt të ndryshëm nga më parë dhe plot ngjyra, për të na ofruar të gjithëve një lexim koxzzmik! Por çfarë po ndodh ndërkohë me Çarli Buketin dhe Vili Vonkën pasi lanë pas Fabrikën e Çokollatave? Ashensori i madh prej xhami po vozit hijshëm lart në qiell, treqind metra mbi Fabrikën e Çokollatave! Vili Vonka, Çarli Buket dhe familja e tij mund ta shohin gjithë botën poshtë tyre. Mirëpo ata nuk e dinë që nuk janë vetëm atje lart! Në hotelin hapësinor SHBA, mrekullia e arritjeve të epokës kozmike, i cili sapo është lëshuar në orbitë, kanë hyrë vermicjet përbindëshe, qeniet më lebetitëse të krejt universit... Me shqipërimin mjeshtëror të Naum Priftit, "Çarli dhe ashensori i madh prej xhami" është dhurata e përkryer për festat e fundvitit!

## NJË NATË PËR FILMIN QË NUK U SHFAQ KURRË

Programi i ri i AQSHF-se, "Thesaret e Arkivit" ka vijuar me projeksionin në 35mm të filmit "Histori zyrtare" - THE OFFICIAL STORY (1985), me skenar dhe regji nga Luis Puenzo. Një prej filmave më të mirënjohur argjentinas, "Histori zyrtare" rrëfen dramën e një mësueseje në fund të diktaturës ushtarake në Argjentinë, që provon të gjejë se kush është nëna e vajzës së saj të adoptuar. Terrori politik që mbërtheu Argjentinën, preku edhe vetë ekipin e filmit ndërsa xhironin. Norma Aleandro u vlerësua me çmimin e "Aktorja më e mirë" në Festivalin e Kanës, ndërsa filmi fitoi çmimin Oskar si "Filmi më i mirë i huaj". Filmi erdhi në AQSHF nga fundi i viteve 1980 dhe nuk është shfaqur asnjëherë deri tani. Ai qe përzgjedhur në "Cannes Classics" 2015 në festivalin e Kanës.



Mbrëmja Gala 2018-19
MAK ALBANIA HOTEL
31 Dhjetor 2018
20:30
PJESË E KASTRATI GROUP
MAK ALBANIA HOTEL
Nata e ndërrimit të viteve!
99€ për person
Menu me 7 raunde dhe pije të përfshira
Muzikë dhe Argëtim Live nga këngëtarët Altin Goci, Marsela Çibukaj, grupi Ali Pashe Tepelena dhe cirku i Tiranës
Gëzuar Vitin e Ri me “Moet Chandon” dhe fishekzjarre në tarracën e Infinity Bar
Shorte me dhurata
Për prenotime deri me datë 20 Dhjetor, për cdo 6 persona i 7-i falas
Ofertë speciale akomodimi për muajin Dhjetor 75 euro çifti
Terma dhe kushte
Menu speciale për femijë me 50% zbritje për moshën 5-12 vjeç
Fëmijët 0-5 vjeç falas
Parkim i garantuar pa pagesë
+355 4 2274 707
+355 69 20 25205
sales.tirana@makalbania.com

E DIEL
23 Dhjetor
2018

MILOSAO



NGA ARISTOTEL MICI

Në nderim të 550-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbe

# Princi arbër që tregoi familjen Kastrioti

Gjon Muzaka, i biri i despotit të principatës së Muzakajve, Gjin Muzaka, në vitin 1510 ka lënë me gjalljen e vet një gjenealogji të fisit të tij princëror. Vepra është e llojit të veçantë dhe e shkruar Italisht në kushtet e emigracionit. Kur Gjon Muzaka shkroi këtë "Memorie" ishte koha që po flitej për organizimin e një kryqëzate antiturke. Autori i saj ka pasur për qellim kryesor t`u tregonte bijve të tij kufijtë e principatës, që, po të ktheheshin rishtas në trojet e tyre pas ikjes së turqve, të dinin se ku i kishin trevat e krahinat, të cilat u përkisnin si trashëgim. Në të njëjtën kohë ai deshte t'u bënte të ditur trashëgimtarëve të tij edhe se me cilat familje të asaj kohe kishte pasur të bënte principata e tyre. Disa nga dyert e fiseve të mëdha, ku ata Muzakajt, kishin pasur lidhje krushqije, farë e fisnije dhe përzierje gjaku , kishin mbetur pa trashëgimtarë, kështu që tokat dhe pronat e tyre duhej t'u jepeshin bijve të tij. "Memoria" e Gjon Muzakës u zbulua për herë të parë nga historiani gjerman Karl Hopfi në bibliotekën Brankacine të Napolit në vitin 1863. Mbas 10 vjetësh ai e botoi të plotë në vitin 1873 në librin "Kronikat Greko-Romane [Chroniques Greco-Romane, - Berlin 1873"]

Kjo biografi fisnore e Gjon Muzakës ka një vlerë të jashtëzakonshme për të ndriçuar sa më mirë kohën e lavdishme të Skënderbeut. Dëshmitë historike të kësaj biografije janë realiste dhe të besueshme. Së pari se autori i kësaj gjenealogjije fisnore ka qenë bashkëkohës i Skënderbeut. Tok me të atin, Gjin Muzakën e më vonë, pas vdekjes së të atit, ai ka drejtuar principatën e Muzakajve deri sa iku në mërgim pas vitit 1479. Së dyti, ai ishte në rrethin fare e fisnor e miqësor të Skënderbeut. Andronika Kastrioti, e shoqja e Skënderbeut, ishte kushurira e parë e tij, nënën e saj, Maria Muzakën, ai e ka motrën e babait. Së treti ,Gjon Muzaka për vetë natyrën e shkrimit të tij nuk është idealizues e as panegjerist.

Zbulimi i kësaj memorie që dokumenton gjenealogjinë e fisit të Muzakajve, po që hedh dritë edhe mbi disa principata e krahina të Shqipërisë të kohës para pushtimit otoman, por edhe gjatë invazionit turk-otoman, tërhoqi vëmendjen e studiusve të kohës.

Pas Karl Hopfit këtë libër do ta analizojë dijetari J.G.Hahni në librin e tij "Udhëtim në viset e Drinit e të Vardarit". Ky dokument shkrimor ka vlerë të veçantë për gjykimin realist të kohës heroike të kryetrimit shqiptar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Duke komentuar veprat, që trajtojnë atë epokë të madhërishme, Fan Noli i radhit ato kështu:"Burimet letrare kryesore të historisë së Skënderbeut janë dy biografitë e tij të gjata prej Antivarasit dhe prej Barletit. Këto plotësohen nga dy biografi të shkurtra prej Dhimitër Frangut e Gjon Muzhaqit" [F. Noli vepra 4 - f 597]

Dhe kur flet konkretisht për veprën e Gjon Muzakës, Fan Noli arsyeton se "......biografia e tij ka më tepër vlerë se të tjerat, të cilat janë shkruar prej panegjeristësh" (Fan Noli -vepra 4 -faqia 599-viti 1989, Tiranë).

Vijon në faqen 14

Në këtë numër: IN MEMORIAM ALFRED UÇI, ARISTOTEL MICI, DEMIR GJERGJI, EIR PLASARI ETJ

Redaktor: Ben Andoni. 367

A
ARGUMENT

*Gjon Muzaka, i biri i despotit të principatës së Muzakajve, Gjin Muzaka, në vitin 1510 ka lënë me gjalljen e vet një gjenealogji të fisit të tij princëror. Vepra është e llojit të veçantë dhe e shkruar italisht në kushtet e emigracionit. Kur Gjon Muzaka shkroi këtë "Memorie" ishte koha që po flitej për organizimin e një kryqëzate antiturke. Autori i saj ka pasur për qëllim kryesor t`u tregonte bijve të tij kufijtë e pricipatës, që po të ktheheshin rishtas në trojet e tyre pas ikjes së turqve, të dinin se ku i kushin trevat e krahinat, të cilat u përkisnin si trashëgim. Në të njëjtën kohë ai deshte t'u bënte të ditur trashëgimtarëve të tij edhe se me cilat familje të asaj kohe kishte pasur të bënte principata e tyre. ..*

# Mesazhi i Gjon Muzakës për principatën e tij dhe Skënderbeun

Në kujtim të poetit Dhori Qiriazi, mikut dhe shokut tim të shkollës, përkthyesit të "Memories" së Muzakës, që ndërroi jetë ca vjet më parë, i cili duke ma dhuruar këtë libër me autograf, më dha shkas të bëja këtë trajtesë

NGA ARISTOTEL MICI

*Vijon nga faqja 13*

Tani këtë "Memorie" të Gjon Muzakës e kemi të përkthyer nga italishtja në shqip prej Dhori Qiriazit, i cili deri vonë qe i njohur kryesisht si poet lirik. Po me përkthimin e "Memories" së Gjon Muzakës, për surprizën e historianëve, ai u shfaq edhe si një studjues skrupulos e analist këmbëngulës i një vepre historike. Përveç përkthimit korrekt e me një gjuhë të përshtatur aq mirë pas origjinalit, Dhori Qiriazi ka meritën edhe për komentet e sqarimet e domosdoshme për ndriçimin e çështjeve historike në momente të ndryshme. Me gjykim realist dhe me kompetencë, me aq sa lejojnë kufijtë e një parathënieje, Dhori Qiriazi analizon dhe interpretimet e nxituara të Hopfit dhe Hahnit lidhur me **Memorien** e Gjon Muzakës, sidomos kur ata në mënyrë të pabazuar kanë identifikuar mbiemrat fisnor me etninë. Autori i parathënies fton linguistët që ta studjojnë këtë vepër edhe për anën gjuhësore, veçanërst për toponomastikën dhe dukuritë fonetike të tingujve të shqipes.

Duket qartë që informacioni kryesor që merr lexuesi nga kjo vepër është ai që ka të bëjë me kufijtë e principatës së Muzakajve, të cilat fillonin nga Myzeqeja ,Vlora, Kanina e Rexhina dhe mbaronin në Kostur, Ohër e Prespë. Po pretendimet për pronësitë e familjes e të fisit të tij Gjon Muzaka i sheh përtej kufijëve të principatës së vetë. Ai gjykon ashtu duke u mbështëtur edhe në prikat e lidhjeve midis krushqive për rastet, kur trashëgimtarët ishin vrarë a po zhdukur gjatë luftërave ose nga shuarja e vazhdimësisë së ndonjë trungu fisnor. Kështu është përshembull, kur ai do të futë brenda pronave të veta edhe Gjirokastrën e kështjellën e saj. " Zonjë Kirana, gjyshja ime, qe e bija e Zot Gjon Zenevisit , Zot i Gjirokastrës dhe i vendit të lartpërmendur...kështu që na takon neve kjo tokë....të cilën Zonja Kirana , gjyshja ime , e pati prikë.(Memoria- f.38 ).

Po në këtë mënyrë arsyeton Gjon Muzaka edhe për zonat e Ohrit, Kaninën edhe Vlorën: "Dhe për më tepër ka një vend tjetër që i thonë qyteti i Ohrit...ky vend ishte i Zot Gropës, që pati për grua Zonjën Kirana, të bijën e dytë të Zot Andrea Muzakës dhe me që nuk la trashëgimtarë, na takon neve.........Dhe ta dini ,bijtë e mi, siç kam thënë edhe më sipër, që mbreti Balsha ka pasur për grua Zonjën Komitë Muzaka, të bijën e vogël të Zot Andrea Muzakës, Despotit, nga të cilët u lind një vajzë, Rexhina, dhe kjo që e martuar me Markon, mbretin e Serbisë, së cilës Gjon Muzaka, vëllai i të përmendurës Komita, ia dha prikë të përmendurës Rexhinë Vlorën dhe Kaninën..Mirëpo më vonë kjo vdes pa lënë trashëgimtar,....bile nuk la trashëgimtar as e ëma, Komita, me mbret Balshën . Dhe tani, me që s`ka asnjë trashëgimtar prej tyre, shteti i përmendur i kthehet dhuruesit, kështu që ju takon juve dhe në këtë mënyrë kalon sipas së drejtës në domenet e shtëpisë së Muzakajve. - ( f.39).

Duke këshilluar të bijtë dhe nipërit e tij lidhur me trevat e kufijtë e mundshëm të principatës , Gjon Muzaka nuk harron të nënvizojë edhe ndonjë qendër me rëndësi të veçant ekonomike, siç ishte një minierë ari me vlera të çmuara për atë kohë në zonën e Tomorricës:

Shikoni, bijtë e mi, në vendin tonë të Tomorricës është një fshat me emrin Orkova, që ngrihet në cep të një mali dhe ky fshat, që përmenda ka një lumë, që kalon në anën tjetër dhe, midis fshatit dhe malit kalon një rrymë uji, dhe pranë kësaj rryme uji, karshi malit, është një *damar ari*, në origjinal (**vena d'oro),** ta mbani mend mirë se është toka jonë- (f.38).

Duke shkruar për trungun gjenealogjik të familjes së tij princërore e despotale, Gjon Muzaka, në të njëjtën kohë përpiqet të japë edhe gjendjen historike të Arbërisë së atëhershme si edhe tatëpjetën e Perandorisë Bizantine. Me aq sa e lejonte kujtesa dhe ne rrethanat e mërgimit, ai kërkon të informojë në radhë të parë trashëgimtarët si dhe gjithë lexuesit për shfaqjet e sulmeve të para turke e deri tek betejat e mëdha të më vonëshme, që tronditën Përandorinë Bizantine, e cila po dobësohej edhe si pasojë e ambicjeve karrieriste për pushtet në elitën perandorake. "Dhe ta dini se si filloi shkatërrimi i Përandorisë së Kostandinopolit që qe edhe i yni, për shkak se qe një mosmarrëveshje midis Paleologut (Johan Paleologu V -1347-54 ) dhe Katakuzenit ( 1341-55 ), gjë që e shtyu Paleologun t`i kërkonte ndihmë Muratit, mbretit të turqve- ( f.19). (Bëhet fjalë për vitin 1354, pra kur në fron ish Orhani dhe jo Murati) ......

Ndër kohë ballkanasit, duke parë sulmet e parreshtura e të gjithë-anshme të ushtrisë turke, bën përpjekje të përbashkëta, për të përballuar rrezikun real, që po u




## Pjesa e "Memories"

Pjesë interesante e " Memories"që tërheq vëmendjen e lexuesve dhe sidomos të historianëve , është ajo kur Gjon Muzaka trajton figurën e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Ai e ngre lart atë si një personalitet të shquar, udhëhëqës dhe komandant të talentuar. "Ky zotëri i përmendur ishte praktik në luftë dhe i guximshëm dhe u bë komandant dhe të gjithë i bindeshin

## Për Skëndërbeun

"Dhe ky i përmenduri Skënderbe mori per grua të bijën e zot Arianit Komnenit dhe ky zot dergoi si dorëzanë Zot Gjinin, tim atë, pse ky i përmendur Arianit ishte kunati i tim eti dhe kishte për grua Maria Muzaka, të motrën e tim eti, siç thashë përmes të cilit qe përfunduar martësa. ( Skënderbeu u martua me Andronikën në vitin 1450 - shënimi ynë ) Dhe mori zonjën Andronika Komnennjatën për grua, e cila ishte kushërira ime dhe përdori më pas mbiemrin Skënderbega nga i shoqi... dhe së fundi ky i lartëpërmënduri zotëri u shkaktoi shumë kërdira turqëve dhe pati shumë fitore [f 21]. Dhe mori zonjën Andronika Komnennjatën për grua, e cila ishte kushërira ime dhe përdori më pas mbiemrin Skënderbega nga i shoqi... dhe së fundi ky i lartëpërmënduri zotëri u shkaktoi shumë kërdira turqëve dhe pati shumë fitore [f 21].



A ARGUMENT

*Kalendarët e përbashkët nuk është se i kanë dhënë frymë impakti artit në të dyja vendet, kurse shihet se rrugët e Kosovës dhe Shqipërisë janë të ndara në art dhe madje ka frymë që nuk i qas qysh në bashkëpunimin esencial. Lufta e marketingut për të shpallur vlerat dhe për t'u afirmuar me anë të tyre në një farë mënyre kërkon që të shmangen shumë gjëra. Dhe, pa asnjë mëdyshje dhe ato që kanë lidhje me patetizmin e memorandumeve...*

# A mund ta ndihë Kosova në kulturë Shqipërinë dhe anasjellas?!

NGA BEN ANDONI

Dy qeveritë shqiptare të kohës kanë zhvilluar pesë takime mes tyre. Të rrethuar me skenografi patetike, por edhe shumë të goditura për t'i dhënë frymë shqiptarizmës, ato janë dukur me shumë si ushqim për nacionalistët dhe mllefin e fqinjëve sesa realisht të vyera për bashkëpunimin. Pak ditë më pas, marrëveshjet janë treguar se fusnin ujë nga të gjitha anët dhe se nuk ishte aq e lehtë, që Shqipëria dhe Kosova t'ia dilnin të bënin sëbashku shumë gjëra, që nënshkruheshin. Në ekonomi është provuar lehtë se marrëveshjet tona janë gjithë probleme se barrierat janë ende shumë të vështira, tregu i përbashkët mbetet ende iluzion etj. Por, nga ana tjetër dhe kultura ka treguar se nuk është në atë frymë që mendohet dhe shpallet nga ministrat respektivë. Kalendarët e përbashkët nuk është se i kanë dhënë frymë impakti artit në të dy vendet, kurse shihet se rrugët e Kosovës dhe Shqipërisë janë të ndara në art dhe madje ka frymë që nuk i qas qysh në bashkëpunimin esencial. Lufta e marketingut për të shpallur vlerat dhe për t'u afirmuar me anë të tyre në një farë mënyre kërkon të shmangen shumë gjëra. Dhe, pa asnjë mëdyshje dhe ato që kanë lidhje me patetizmin e memorandumeve.



Të dy vendet tona luftojnë më shumë për afirmim, por duket se avantazhi është nga Kosova që ka një qasje më të afërme me tregun e huaj dhe ka treguar se funksionon shumë më mirë. Inerci mbase e kohës së shkuar por edhe e konfigurimit shtetëror kosovar, ku faktori i huaj është jo vetëm prezent por edhe tepër ndihës, sa i përket lidhjeve dhe jehonës artistike në qarqe më elitare. Dhe, në artin kosovar ke elementë pafund që kanë qasje ndërkombëtare dhe projekte të huaja, por edhe aktivitete që janë realisht shumë më të mira se në Shqipëri. A ka gjasë që kosovarët dhe shqiptarët të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin? Për sa kohë lufta e tregut kërkon evidentim ajo do konkurrencën dhe ajo bëhet ndaras në vetë tregun kosovar dhe te tregu shqiptar. Që do të thotë, problemi është zgjidhja e gjërave që janë në vetë tregjet e brendshme dhe pastaj mund të mendohet për bashkëpunimin. Shqiptarët janë ende produkte të një tregu që lë shumë për të dëshiruar dhe me politika tejet inferiore. Por më i madh problemi është se të dy vendet nuk kanë një synim të përbashkët sesi të inkurajojnë artin e përbashkët ose një produkt që të jetë më i mbathur me vlera. Projektet që ofrohen të paktën nga Ministria e Kulturës janë aq të vogla saqë ato janë të pamjafta që një njeri të punojë për projekte më të mëdha. Ose më saktë, Ministritë respektive të Kulturës zgjidhin sensin e projekteve të vogla, që "t'i kënaqin" të gjithë. Enver Petrovci e shprehte hapur në një intervistë në një të përditshme, kur tregonte modelin e shkuar dhe faktin që njerëzit që kishin treguar se mund të bënin gjëra të mira inkurajoheshin për më shumë. Një gjë që nuk ndodh sot. Ashtu, si nuk ndodh, ideja e kryeministrit për të përcjellë burokratët kosovarë në administratën shqiptare. Rasti i drejtorit të Galerisë Kombëtare të Arteve dhe heqja dorë pa dhënë asnjë shpjegim nga aktiviteti i saj më prestigjioz "Onufri" tregon se shumë gjëra nuk funksionojnë mes nesh, por më shumë ajo frymë që besohet të mbillet nga politikanët. Burokratët që vinë më pas poshtë tyre dhe që duhet t'u japin frymë gjërave janë minues të çdo fryme të mirë sepse në kokë kanë ende stereotipat. Mu ato që na mbajnë aq të ndarë realisht me njëri-tjetrin. (Milosao)

---

kanosej. Kështu në vitin 1389 në Kosovë u bë një përplasje e madhe ndërluftuese, një betejë e përgjakshme midis aleatëve ballkanas dhe ushtrisë turke, që quhet në histori *Lufta e Kosovës.* " Lazari, Despoti i Sërbisë dhe mbreti Marko i Bullgarisë, dhe Theodhor Muzaka i familjes sonë, dhe zotër të tjerë të Shqipërisë, u bashkuan dhe shkuan në betejë, ku të krishterët humbën dhe aty u vra i lartpërmënduri Theodhor (Muzaka), që kishte me vete një ushtri të madhe shqiptarësh.".....Këtu do të fillonin luftra të vazhdueshme me turqit në Shqipëri. Theodhor Muzaka njihet historikisht kështu si dëshmor i parë I trevave arbërore në epopenë e gjatë të luftrave antiosmane.

Zot Andrea Muzakës, tim gjyshi, iu vërsul me një vrull të tillë Bajaziti dhe i mori një pjesë të Devollit dhe të Myzeqesë, të cilat ia mori prapë..(janë ngjarje të vitit 1394- shënimi ynë).... Edhe Zot Gjini, im at dhe gjyshi juaj, e zotëroi shtetin atëror që përmendëm, pse edhe kur e humbi Myzeqenë, e mori prapë. (..........................) Zotërit e rinj të Shqipërisë u vranë të gjithë në luftë..Mbëtën gjallë këta zotër : Zot Aranit Komneni, Zot Gojko Balsha, Zotërit Nikollë e Pal Dukagjini, Zot Gjin Muzaka, im at, Zot Andrea Topia, Zot Pjetër Spani ( f.19 )

Në faqen 28 të " Memories " autori tregon për zanafillën e gjenealogjisë së tij. I pari i fisit del Andrea Mollosaku. Nga ai u lind Theodhor Muzaka Kishetësi (nënkupto -Keshetësi, ose Gërshetësi, sepse mbante flokët gërshet). Nga ky zot u lind Andrea Muzaka i dytë, që mundi bullgarët tek Mali i Peristerit dhe që perandori i Bizantit i dha titullin e despotit si dhe stemën me fushën e kuqe dhe me shqiponjën dy krenare në mes. Pastaj nga ky i lartpërmenduri Andrea Muzaka i dytë, Despot, u lindën tre bij dhe dy bija. Djemt ishin Gjini, Theodhori dhe i treti Stoja. Nga dy bijat, e para e kishte emrin Komita dhe e dyta Kirana. Bija e tij e parë pati për burrë mbret Balshën, i cili mbante në zotërim Shkodrën, Tivarin, Kotorin, Shebenikun...... vajza tjetër Kirana pati për burrë zotin Gropa, zoti i Ohrit deri në Dibër.



Zot Gjinit të lartpërmëndur do t'i lindin pesë bij. I pari e pati emrin Andrea [Andrea Muzaka i tretë-shenimi ynë]. Ky Zot Andrea i tretë pati dy bijë dhe dy bija. I pari e mori emrin Zot Gjini i dytë dhe i dyti Zot Theodhor Muzaka. Bija e parë e kishte emrin Maria dhe e dyta Zonja Helena. Ky i quajturi Zot Gjini i dytë pati për grua Zonjën Kirana, e cila ishte mbesë e Zot Pal Sevastokratit dhe prej të lartpërmendurit Zot Gjin kam lindur unë Gjoni. I lartpërmënduri Zot Theodhori i dytë.....u vra në luftë me Sulltanin ( në Luftën e Kosovës ) dhe nuk la trashëgimtar............dhe Zonja Maria , motër e tim ati, e cila pati për burrë Zot Arianit Komnenin, që ishtë Zot i Çermënikës, i Mokrës dhe i Shpatit deri në lumin Devoll, që e ndan vendin e tij me të tonin. E dyta (motër) Zonja Helena, që thamë, që martuar më Zot Filipin që kishte një zotërim të madh në Raguzë. Nga Zonja Maria dhe Zot Arianit Komneni lindën tetë bija. E para u quajt Zonja Andronika.......bija e parë pati për burrë Zot Skënderbe Kastriotin. Nga kjo Zonja Andronika dhe Zot Skënderbeu u lind Zot Gjon Kastrioti , që qe Dukë i Shën-Pjetrit në Galatinë dhe ky i quajturi Zot Gjoni pati për grua Zonjën Dukeshë Erina Paleologa, që qe bijë e Zot Lazarit, Despot i Sërbisë dhe prej këtyre u lindën shumë fëmijë, po vetëm dy prej tyre mbetën gjallë; një djalë dhe një vajzë, princ Ferrant Kastrioti që është duk i Shën-Pjetrit dhe vajza e mban emërin Princesha Maria Kastrioti.(f.-32 ).

Në pleqërinë e tij të tellë, drejë vitit 1510, prince Gjon Muzaka vazhdon të meditoj për vendlindjen dhe sikur ëndërron që turqit do të largohen një ditë nga Arbëria. Me këtë shpresë në zemër, mendon t'u bëj të tre djemëve edhe një testament, duke ua ndarë principatën me gjalljen e vet. Dhe ja se cfarë shkruan Gjon Muzaka në Memorien e tij:

Unë po jua ndaj principatën ju bijve të mij, Zoti, për mëshirë ua lëntë në dorë. Ty Zot Theodhori, që ke lindur i pari, të lë Beratin dhe të gjithë zotërimet e tij, të gjithë Myzeqenë dhe qytetin e Kaninës dhe zotërimet e saj dhe Skraparin.

Ty Zot Adriani të lë Tomorricën me të gjithë fshatrat, Serkën,Midhenjin dhe Serezin, edhe Dushkarin, Oparin dhe Lavdarin, Marianin dhe Voskopebecin dhe gjithashtu ç'kuptohen, siç thashë me krahinën e Oparit, dhe të Lavdarit deri në fshatin Marian të lartpërmendur dhe gjithashtu të lë krahinën e Devollit të madh me qytetin e Korcës dhe fshatin Sovian.

Ty Zot Kostandini të lë gjithë krahinën e Devollit të vogël dhe qytetin e Kosturit, ose Kostories me gjithë fshatrat e tyre deri në Nostram që është një qytet i shkatrruar. (f.42)

Koha tregoi se shpresat e Princit Gjon Muzaka, që bijtë e tij të ktheheshin në trojet e tyre në Arbëri, nuk u realizuan. Po sidoqoftë, nga testamenti i tij dhe Memoria në përgjithësi, ne sot arrijmë të kutojmë realisht kufijtë e principatës së Muzakajve si dhe lidhjet , që kishin Muzakët me principatat e tjera dhe sidomos me kryeheroin Gjergj Kastrioti-Skënderbeun.

→Vijon numrin e ardhshëm

P
PUBLICISTIKA

*Në 88-vjetorin e lindjes po e kujtojmë prof. Alfred Uçin me një shkrim të botuar në disa numra të gazetës "Albania" në vitin 2004. Në ndryshim me pjesën më të madhe të krijimtarisë të tij të gjerë shkencore dhe publicistike, ku ka trajtuar kryesisht probleme filozofike, estetike, probleme të teorisë, së letërsisë dhe të kritikës letrare, që kanë patur një auditor lexuesish të kufizuar, ky shkrim i drejtohet një auditori shumë të gjerë, sepse tërheq vëmendjen për një aspekt shumë të rëndësishëm të jetës të të gjithë njerëzve. A nuk është edhe sot shumë e mprehtë nevoja për të tërhequr vëmendjen sidomos të brezit të ri, por dhe të familjes dhe shkollës drejt librit dhe leximit në përgjithësi?!*

# TE DISH TE LEXOSH, ÇFARE TE LEXOSH, E SI TE LEXOSH

NGA PROF. ALFRED UÇI

Ka gjëra ose veprime kaq të rëndomta, të zakonshme, të përditshme, saqë shpesh jemi të bindur se u a njohim mirë thelbin, strukturën, funksionin, rolin dhe prandaj do të na dukej absurde, në mos qesharake të pyesnim se c' janë. Më duket se një veprim i këtij lloji është dhe leximi(lëçitja) si tillë, por po të pyesnim se ç'është ai jo vetëm njerëz fare të rëndomtë , por edhe intelektualë të regjur me lexime gjithëshfarëshe, ndodh të na japin përgjigje fare të cekta ,të njëanshme,madje edhe banale.

Po ç'ka më nxit, të shpreh ca mendime për këte problem, janë disa shqetësime të ditëve tona që shfaqen në shumë familje: Përse shumë fëmijë, por jo vetëm fëmije nuk kanë dëshirë të lexojnë?Situata është shqetësuese kur mësojmë se nuk ka fonde për të blerë libra sipas profileve që kanë bibliotekat qendrore të universiteteve,fakulteteve ,institucioneve shkencore e kulturore,pale fonde për botime të huaja.

Siç është problem kriminaliteti, korrupsioni, trafiqet, varfëria etj., është bërë problem i rëndesishem social- kulturor dhe mosleximi,tatëpjeta e tij në përmasa frikësuese. Këtu nuk kemi të bëjmë thjesht me shije personale, por me nje plagë sociale,që dëshmon për një prirje disi të padukshme,të fshehtë ,që i kundërqëndron me forcë të madhe asaj perspektive,për të cilën flitet shumë ,për të hyrë si komb qysh në fillim të shek.XXI drejt një qytetërimi modern ,për t'u integruar në Bashkimin Europian.

Shqetësim është se leximi është duke u rrudhur dhe është fatkeqësi kur libri ka fituar lirinë e plotë , madje të tepruar me disa botime që më mire të mos ishin.Kur përpiqemi të përcaktojmë faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit të njerëzimit,të qytetërimeve,ne na shkon mendja lehtësisht te kultura, ekonomia , shkenca, teknika, feja, morali, filozofia, etj. Po kështu mund të përmendim disa nga shpikjet e zbulimet më të mëdha si zjarrin,l even, rrotën, atomin, elektricitetin, artin, kompjuterin,etj.

Por çuditërisht nuk na shkon mendja ta përfshijmë ne këtë rrjesht ose në krye të tij LEXIMIN .Shpesh kjo harresë ushqehet edhe nga ndonje keqkuptim rreth zanafillës së vonuar ,siç mendohet,të shfaqjes së leximit si veprimtari e rëndësishme njerëzore. Ne i kemi provokuar pak përpara grupe nxënësish e studentësh ,por edhe mësuesish ,me pyetjen ç'është LEXIMI ? Me nënqeshje ironike ,përsëriten këte përgjigje:-LEXIMI është zotërimi i një alfabeti dhe përdorimi i tij për të lexuar libra. Këtë përgjigje ne e quajtëm të cekët ,gjysmë të vërtetë, në mos banale.

Eshtë e vërtetë se zbulimi,krijimi i alfabeteve ka qene nje nyje e një ngjarje e rëndësishme në jetën dhe historinë e njerëzimit,me të filloi përdorimi i shkrimit dhe dorëshkrimit. Ata popuj që e patën më përpara në kohë këtë vegël,shkuan edhe më përpara në krahasim me ata që s'e patën e u vonuan në qytetërim. Por leximi si i tillë,është më i lashtë se sa alfabetet ,ai është aq i lashtë,sa homosapiens , sa shoqëria njerëzore,të menduarit e të folurit. Sigurisht,nuk e kemi fjalën për leximin e alfabeteve ,që kanë qenë produkte më te vona,por kemi parasysh leximin natyror,I cili ka qenë qysh në fillim një kusht i rëndësishëm i ekzistencës njerëzore, një premisë e domosdoshme për komunikim, i shkëmbimit të përvojës njohëse. Me të drejtë thuhet se sikur të ndërpritej qoftë edhe për një kohë të shkurtër prodhimi global ,shoqëria do të ndodhej para një katastrofe të pariparueshme,por ne do të mund të pohonim po kështu se po t'i kishte munguar njeriut aftësia për të lexuar,shoqëria do të kish qenë e paaftë për të prodhuar,pra për të ekzistuar.Leximi e ka përcjellë njerëzimin



jo vetëm në kohët parahistorike,por ky veprim vazhdon ta përcjellë atë në gjithë aventurën e ekzistencës së tij.Leximi është vegël e pazëvendësueshme me asgje tjetër. Nuk është e rastit që në Bibël është thënë:" Në fillim qe Fjala"

Një rëndësi të jashtëzakonshme patën bibliotekat e para që u ngritën ,që fituan prestigjin e faltoreve dhe të bankave të thesarit ,të begata në vlera intelektuale dhe me fuqi të madhe tërheqëse. Pa shkrimin nuk do të kishim patur "Dhjaten e Vjetër"," Zurenik","Kodikun e Purpët" apo "Kodikun e Artë",apo gjithë veprat e shkrimtarëve të Antikitetit dhe Mesjetës.

Leximi ka ushqyer fuqinë e dijes ,e qytetërimit,progresit,prandaj ka patur ithtarë të përgjëruar të leximit e të shkrimit,martirë të vërtetë për Diturinë,por progresi ka patur dhe armiq të betuar që kanë ardhur nga stani Injorancës sic pat ndodhur me Sokratin që piu helmin ose me Platonin- skllav me atë Mulla Omarin që dogji bibliotekën e madhe të Aleksandrise, nisur nga mendimi se njerëzve u mjaftonte Kurani që demek kish të gjitha ç'i nevojitet jetës ose si Inkuzicioni që digjte gjatë Mesjetës librat dritëdhënëse se bashku me autorët e tyre,Xh.Brunon etj.,që e detyroi Mendjen e ndriçuar nga leximi të strukej për të lexuar në manastiret ,në qelitë e tyre ku ruhej libri. Martirë të vërtetë të librit ka pasur edhe Shqipëria si P.N.Luarasi,që përkthente në shqip dhe përhapte abetaren në shkollat e para rilindase të vendit tonë

Një revolucion i madh që ka ndodhur në historinë e librit qe shtypshkronja tipografike,mekanike e Gutenbergut, në të cilën me 1448 u shtyp për herëte pare "Bibla".Me kohë në kuadër të Revolucionit industrial u realizua një progres i madh i industrisë tipografike,që e ka bërë të mundur prodhimin e librave në sasi kolosale dhe uljen e kostos së riprodhimit të tyre. Ky progres ka qenë shoqëruar dhe me rritjen e vazhdueshme të kërkesave për libra brenda sistemeve bashkëkohore arsimore e jashtëarsimore,si dhe me përsosjen e pasurimit kolosal të bibliotekave të profileve të ndryshme,duke përfshire dhe ato personale,të sistemit të shpërndarjes,të tregtimit dhe të propogandimit të librit. Edhe brezi ynë ka patur fatin të shijoje dhe po shijon rritjen e botimeve tipografike dhe të tirazheve të tyre. Eshtë kënaqësi që shikojmë në libraritë gjithë ato libra,madje dhe ato "të ndaluara ","të mallkuarat" që i shihnim në libraritë e vendeve të tjera dhe që ndërronim të kishim dhe në shtëpitë tona.

Tema e leximit në jetën bashkëkohore është bërë një temë e parapëlqyer në cdo vend të botes.Ajo përcillet me diskutime e debate të shumta. Shqetësimet për problemet e leximit kanë filluar pas Luftes së Dytë Botërore ,kurse jehona e diskutimeve të thella ka arritur vone, megjithkëte më mire vonë se kurrë. Problemet që ngre E.Montale ,shkrimtar nobelist i mirënjohur, në esenë me titull "Arti i leximit"janë bërë aktuale edhe për jetën kulturore e sociale të shoqërisë sonë. Montale i është referuar kryesisht leximit të letërsisë artistike dhe prandaj e çmon si atribut të pandarë të leximit kënaqësinë estetike,kurse ne duam ta trajtojmë leximin në kuptimin më të gjerë të fjalës ,si akt specifik të leximit të çdo gjëje të shkruar e të botuar,të leximit në përgjithësi , të çfarëdollojshëm që njeriu e bën për arsye shumë të ndryshme. S' ka dyshim se shumica e njerëzve që lexojnë sistematikisht përfitojnë kënaqësi ,e cila është një stimul e një akt psikologjik emocional,që përcjell në mënyrë suksesive leximin.Po qe se libri të pëlqen ,e lexon me një frymë deri në fund,por kur nuk të pëlqen e mbyll dhe e flak tutje.Ka shumë libra që të pëlqejnë,por ka dhe libra që s' të pëlqejnë. Cdo njeri është i detyruar dhe lexon edhe libra që s'i pëlqejnë. Kështu cdo nxënes ose student për të plotësuar programin mësimor është i detyruar pavarsisht nëse i pëlqen ose jo të bëjë lexime të detyrueshme.Dhe s' ka besoj ndonjë nxënës apo student që të pëlqejë çdo tekst të çdo lënde mësimore që të kënaqet , ta shijojë si gjë të këndshme ,jo vetëm kur teksti është i rëndë,i mërzitshëm,i pakuptueshëm,por edhe kur është i thjeshtë,i shkruar mire,por i një lënde që s'pëlqehet.Ndodh që leximet e detyrueshme që s'pëlqehen bëhen faktorë që kultivon te lexuesit alergji ndaj leximit në përgjithësi .Por kjo që pohuam tregon se leximi është dicka më e gjerë se sa leximi thjesht për kënaqësi.Nuk bën të mendohet sa kënaqësi i sjell njeriut vetëm leximi i letërsisë, poezisë, teksteve artistikë. S' ka dyshim se cdo tekst artistik pëlqehet ngaqë domosdoshmërisht ka një natyrë estetike dmth hartohet që të krijojë lidhje emocionale me lexuesin,të pëlqehet, te dhurojë kënaqësi. Por ka edhe shumëraste kur disa lexues parapëlqejnë tekste të vështira , matematike, fizike, biokimike, tekste të ngarkuara me sisteme shenjash simbolike të ndërlikuara dhe megjithkëte përfitojnë kënaqësi më të madhe nga cka të dhurojnë tekstet artistikë,që në krahasim me tekstet shkencorë i quajnë" Përralla ",i quajnë fantazi së koti. Kjo tregon që në këto raste lexuesi njeh raportin midis tekstit e realitetit,sepse dhe leximi mund të jetë shkencor , i pëlqyeshëm dhe përfton kënaqësi,sepse i dhuron lexuesit dije të sakta shkencore ,kurse po këtij lexuesi nuk i duket i mbushur me gjepura,me gënjeshtra,me trillime fantastike. Shembujt që përmendëm tregojnë se leximi nuk është thjesht kënaqësi. Leximi është një akt i ndërlikuar kulturor, shkencor, psikologjik dhe nuk reduktohet vetëm në rastet e leximit të këndshëm argëtues. Krijimi i veprave artistike,i teksteve letrare poetike është njëlloj pune sigurisht e një lloji të vecantë, por gjithsesi punë. Eshtë një impenjim kryesisht mendor, intelektual, emocional, psikologjik,por edhe fizik, po të teprohet leximi bëhet i lodhshëm ,i mundimshëm sic është cdo punë. Leximi nuk është angazhim thjesht për t' u dëfryer,për të të zënë gjumi ose për të vrarë Kohen. Ai është angazhim që e nënkupton lodhjen që mund të të pëlqejë po që dhe mund të të mos pëlqejë.

Brezi i ri duhet te mësohet ta kuptoje se leximi është një investim drejt së ardhmes për një profesion të parapëlqyer,për një jetë më produktive ,për të përballuar kërkesat e shkollës ,të kulturës,shkencës , qytetërimit. Njeriu që s' lexon në kohen tone mbetet injorant,gjysmak ,nuk e gëzon lirine, zgjedhjen e veprimit. Nëse e pranojmë leximin si punë atëhere duhet të flasim edhe për mjeshtrinë e të lexuarit. Cdo lloj pune është art ,mjeshtri më vete.Cdo mjeshtri ka sekretet e marifetet e veta. Secila dallohet për nga lloji i dijeve,i përvojës,nga mjeti që përdor dhe që e drejton drejt veprimtarisë së qëllimshme. Edhe leximi si njëlloj mjeshtrie ka specificën e vet.Ai ka një qëllim drejt së cilit synon . Eshtë nje angazhim serioz i njeriut për të.

**Duhet TE DISH TE LEXOSH ,CFARE TE LEXOSH, E SI TE LEXOSH.**

Ka njerëz që lexojnë ,po kur mbarojnë së lexuari qoftë dhe një text minimal nuk janë në gjendje të tregojnë se cfarë lexuan e cili qe kuptimi i tij.TëLEXOSH do të thotë të përvetësosh informacionin e plotë që është depozituar në përmbajtjen e fjalëve,të shkrimit,të tekstit. Struktura e cdo teksti nuk është e njëjtë.Ka tekste të rënda që kërkojnë një impenjim më të forte intelektual e fizik të lexuesit.Duke u nisur nga tekstet e vështira shkencorë e jo shkencore ,për të deshifruar kuptimin e shumekuptimin e tyre janë formuluar dhe këshilla e rekomandime praktike për mënyrat e leximit. FAGUENTI , studjuesi i mirënjohur i leximit në përgjithësi, ndaj pyetjes se si duhet lexuar ,ka dhënë këtë përgjigje : së pari të lexohet shume ngadalë, së dyti të lexohet shumë ngadalë dhe së treti të lexohet shumë ngadalë. Kjo këshillë që trefishohet,sigurisht është e dobishme në përgjithësi dhe vlen për ta mbrojtur lexuesin nga një lloj leximi i përshpejtuar e diagonal ,qe kryhet zakonisht nga cektësia kulturore e lexuesve ,që priren për të mos e vrarë mendjen ,kurse leximi i ngadalshem,i vëmendshëm është mënyra më e frytshme duke nxjerrë gjithë informacionin nga cfarëdo lloj teksti sidomos nga tekstet e vështire e me densitet të madh informativ.

Edhe tek ne ka marrë përpjetë botimi,

## ...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri nuk ishte më poshtë se dy numrat paraardhës. Mund të themi se argumentet kanë qenë tepër interesantë dhe nga ana tjetër kanë treguar një performancë të mirë në fund të këtij viti. Urojmë të vazhdojmë kështu.

Duke marrë shkas nga ngjarja e ardhjes së eshtrave të Mit'hat Frashërit dhe mënyrën sesi është ofruar te publiku i vendit, autori Armand Plaka, i pasionuar pas dokumenteve gjermane na solli atë që thuhej për Shqipërinë pas Nurembergut. Gjyqi i famshëm i hapi udhë arrestit të shumë vetave, që kishin bashkëpunuar me fashizmin dhe vendi ynë nuk mund të bënte përjashtim, por "Neue Zeit", një gazetë ish-gjermanolindore në vitin 1945, në zonën që administrohej nga forcat sovjetike dhe vetëm një muaj para nisjes së operacionit më të famshëm të drejtësisë ndërkombëtare, pohon se nga pala shqiptare në këtë "listë të zezë", nuk rezultonin më shumë se dy emra!!! E habitshme kur mendon paradoksin e asaj kohe dhe kolaboracionistët tanë. Autori u tregua pak më skrupuloz sesa duhet dhe ishte pak si shumë kërkues me rifiniturat, duke insistuar për gjëra të vogla.

Redaktori shtoi një argument për një histori të re arti kombëtare, ku arti dhe historia duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën, për të zbardhur më shumë. Arti s'është përgjithësisht fakt dhe historia nuk mund të jetë kurrë fantazi, paçka se në Shqipëri nga problemi i identifikimit shumë e bëjnë letërsinë të duket histori me plot penegjirizma që e kanë modifikuar dhe vetë gjininë e bukur, kurse historinë që bëjnë shumë pseudo bashkë me shumë gjysmë-profesionistë, është kthyer gati në fantazi, shkroi redaktori.

Luljeta Dano shton një argument në këtë numër që e lidh ndryshimin që ka bërë mes lahutës shqiptare dhe guslës sllave, në kohën kur ky instrument muzikor po njihet nga UNESCO si objekt, që do të mbrohet nga Institucioni më i rëndësishëm i Trashëgimisë Botërore. *"Në kokën e guslës malazeze, boshnjake, serbe, kroate gdhendet vetëm dhia dhe shqiponja e ikonografisë bizantine, ndërsa në lahutën shqiptare elementët shoqërues të epikës legjendare, si gjarpri shërues, ora - gjarpër që paraqitet me fytyrë njeriu, ora e maleve me tiparet misterioze të një fytyre elipsoide, vesh dhe sy jonjerëzorë, shqarthi, kafshë tepër e rrallë në Alpet shqiptare që mbron territorin e vet dhe e siguron atë veç për vete, pasi ndeshet me kafshët e tjera të malit dhe i mbyt, karakter i ngjashëm me vetë kreshnikët, që kujtohen në kreun e lahutës"*, referon ajo studiuesin Jaho Brahaj. Luljeta pati shumë probleme me faktin që duhej bërë një korrigjim, sepse gjatësia e përgjithshme te lahutat e vjetra është afërsisht 65 cm, kurse pesha është vetëm 950 gram. Në fakt, nuk arritëm t'ia realizonim këtë kërkesë.

Na erdhi një argument për veprën e fundit të Luljeta Lleshanakut përkthyer në anglisht nga Ani Gjika, dhe botuar nga shtëpia botuese "New Directions, në Shtetet e Bashkuara, në vitin 2018. Duhet thënë se Luljeta është poetja jonë me më shumë renome ndërkombëtare.

Pas shumë kohës erdhi dhe Faruk Myrtaj me një tregim shumë interesant, ku autori mbeti i kënaqur me zgjidhjen e botimit. Po ashtu, karikatura shqiptare do të përfaqësohet në World Press me punën e fundit të Arben Meksit, të titulluar "The price of glory!" dhe është në vazhdën e abstragimeve të tij tejet interesante. Redaktori zgjodhi ta botojë pak para shfaqjes në këtë event të njohur. Në përgjithësi edhe layout punoi jashtëzakonisht shumë mirë.

shitja e leximi i një letërsie të atillë,që do ta quanim letërsi për të humbur kohen,letërsi për dembele. Plot libra,sidomos revista të ilustruara qe vetquhen" moderne" ,të cilat i ka neper duar nje numër i madh lexuesish ndikojnë negativisht në aftësitë lexuese duke deformuar shijen e kulturuar të leximit,duke e vrarë dhe duke e bërë lexuesin të paaftë për të diferencuar një tekst që meriton të lexohet nga një tekst banal,vulgar,të ceket madje dhe nga ato që i përkasin antikulturës.

Gjysma e dytë e shekullit te 20 ka qenë periudhë e një kthese të pabesueshme e të habitshme në shumë sfera të teknikës e shkencës,por mendoj se më e rëndësishme ka qenë e vazhdon të jetë krijimi i një sistemi krejt të ri, jo tradicional komunikimi, mjete moderne të transmetimit, të informacionit kompjuterik,internet,mjetet audiovizuale, riprodhimet artistike, botimet e filmat vizatimorë, kinematografia televizive, diskotekat, albumet e revistat e ilustruara etj. Të gjitha këto mbartin në vetvete një potencial kolosal akumulimi e transmetimi informacioni kulturor,artistik e shkencor të shumëllojtë. Ky progres po vazhdon me ritme të habitshme,aq sa qytetërimi i shek. XXI ka zënë të quhet" qytetërim i mjeteve dixhitale".Ne asistojmë në aktivizimin e një sistemi të ri,që po e quajmë lexim dixhital. Ka njerëz të informuar mire për progresin bashkëkohor teknologjik,që e konsiderojnë shtrirjen e këtij sistemi si një të keqe të madhe,që kinse po e mënjanon mënyrën klasike të leximit të librit,që po e largon spektatorin nga leximi I librit. Këtë prirje e lidhin me rritjen e jashtëzakonshme të trysnisë së veprimtarive thjesht argëtuese ,zbavitëse, audiovizuale,jo vetëm të varfëra për nga vlerat e mirëfillta kulturore,shkencore ,sociale e informative,madje edhe me fuqinë negative në planin moral.(filmat më shumë qe mbytin ekranet televizive dhe dukuri te tjera me karakter antikulture).Nëfakt ,ky opinion nuk është plotësisht i saktë.Eshtë e vërtetë se në kohën e sotme ekziston një kontradiktë midis mundësive të pakufizuara komunikuese e transmetuese informative të teknologjive moderne dhe një prapambetje relative të kulturës individuale të leximit të librit.Eshtë e vërtetë se sot ekzistojnë masa të mëdha njerzish që lexojnë përmes internetit,që përdorin aparatura dixhitale për të lexuar fondet e bankave informative, të bibliotekave , që lexojnë gazeta, revista, libra të të gjithë bibliotekave tëbotës,të përfshira në internet e në rrugë të tjera informative,me ndihmën e kompjuterave ,që lexojnë filmat vizatimorë, albumet e revistat e ilustruara, që e marrin gazetën në shtëpi etj. Mirëpo këto grupe lexuesish jo vetëm e shtojnë numrin e përgjithshëm të lexuesve, por përbëjnë një kontigjent për herë e më të madh,madje një kontigjent që i përket e ardhmja. Edhe te ne ka filluar të rritet interesimi për të përdorur mjetet dixhitale të leximit. Por frika lind nga keqpërdorimi i këtyre mjeteve moderne të komunikimit ,sidomos të masmediave, të cilat nuk i ndërtojnë emisionet e programet e tyre në përputhje me nevojat e shumanshme të kulturës ,arsimit, edukimit sidomos të brezit të ri dhe kërkesave të zhvillimit të teknologjive modern dhe institucioneve të ndryshme ,që mund të funksionojnë pa aktivizuar mjetet e komunikimit dixhital ,pa i mësuar njerëzit të lexojnë me kulturë dhe me mënyrat e reja të teknologjive moderne.

Ndaj është me shume rëndësi të dimë si dhe çfarë të lexojmë.

# P

## PUBLICISTIKA

NGA EIR PLASARI



### I shkruaj së pamundurës

Ai është i bukur
Si nata e freskët e vereës që
Përkëdhel trupat tanë
Si ndriçimet e dritave
Të një qyteti të gëzueshëm.
Ai është i pakuptueshëm : net'
Të tëra kam ndenjur zgjuar,
Duke u përpjekur të kapja
Thelbein e tij –
Por … e kotë!
Ai është mashtrues,
Por është e pamundur
Ta shohësh duke mashtruar.
Ai dashuron
Por s'e din as vetë përse-
E megjithatë-
Nuk e imagjinoj dot të dashuruar!
Ai ka pësuar një goditje,
Kurrë nuk do të jetë i njëjti…
Dhe unë ndihem kaq bosh
Kur mendoj për këtë!
Mendja e tij aq e dëmtuar,
E pamundur t'ia heqësh dëmin,
Sepse tashmë ai ka mësuar të rrojë
Me të…
Të jetë rastësi që kaq shumë e dua? Pasi
Po ta vështrosh me kujdes
Asgjë të veçantë nuk dallohet tek ai!
Por… ç'rëndësi ka kjo?
Dua të jem aty ku s'mund të jem,
Dua të kem atë që s'mund të kem!
Dua t'i shkruaj së pamundurës,
T'i them që kurrë s'do mund të më ndalojë
Që ta dua!
***
Ditë pas nisjes sime, kishe pyetur
Se kur do të kthehesha?
Kishe marrë një përgjigje: kurrë!
Por nuk qe e vërtetë-
Do të kthehesha
Edhe pse jo dhe aq shpejt…
Frijdi thoshte: Gratë duan
Të kundërtën e asaj që mendojnë…

### Ti nuk je për këtë lloj mërzie

Ti nuk je për këtë lloj mërzie,
Si nuk e kupton?
Të jesh kaq naïve
Nuk të falet!
Sepse je një hyjni –
Edhe mëkati më i madh
Tek ty duket i bukur!
***
Kjo mërzi e jotja
Si një libër
I hedhur pa mëshirë
Në mes të rrugës,
I lënë aty,
Në mes të makinave
Që lëvizin në trafik,
I lënë aty
Me shkronjat
Që derdhen
Në asfalt…

### Dua ta lë trupin diku

Kur dhimbja fillon
Dua ta lë trupin tim diku
Dhe unë, pjesa ime pa peshë,
Pa trup
Të iki, të strehohem,
Larg nga e shpifura dhimbje
Që më përndjek…
Çfarë hobi e perjetshme kjo!
T'i iki dhimbjes.
Qetsomëni duke u ulur
Në zemrën time,
Duke buzëqeshur
Përdore të kapur.
Kur dëshira lart të të ngrejë
Godite dikë me këpucën
E dashurisë!
Fragment nga vdekja e Empedokliut
…E me zemër të hapur u
Betova para atij vendi
Të ashpër e të shumëvuajtur
Në mes të natës së shenjtë-
Që do ta dashuroja atë deri në vdekje,
Pa u epur, pa u frikësuar
Dhe dhash' fjalën që do të pranoj pa
Ngurim, çdo të metë
Dhe enigmën e tij;
Kështu u lidha me të në
Një kordë vdekjeje.

### Ujë dhe orë

Pa kuptim kjo orvatje
Dhe këto orë të qëndisura e të ngrira
Ujë, uji i freskët i mëngjeseve të akullta
Të zhytyra në freskinë e pafajshme…
Shoh fytyrën time në pasqyrë:
Ajo nga vetja më largon,
Të lidhura i kam duart,
Të fikur vullnetin
Përballë teje
Imazhi im.
Orët e qëndisura mbi krye i kam
Dhe vetmia kthehet në një lojë
Mëngjeseve si ky
Kujtoj shpesh fjalët që shkëmbenim dikur
Dhe ato bisedat e lëna përgjysëm…
Sot ky diell i çmendur
I ka zhveshur zgjimet e mia…
Në një furrë egzistenciale
Unë jetoj tashmë.

### Duhen fshirë mendimet

Do kish dashur që netët të mos i përgjigjeshin
E që ditët të ishin po aq të kthjellta si dikur
E përmes të kthjelltave ditë
Të rikthehej ajo magji,
Magjia e dy trupave vezullues!
Por vetëm ditë dimri e prisnin,
Përleshja e ftohtë e asaj stine
Do ta shoqëronte në heshtje
Për shumë kohë…
Aq sa mendimi do të kyçej,
Do të fshihej!
Të ngrira
Në qetësinë e të ftohtit
Mendimet fshihen një e nga një
Edhe pse pjesë e atij trupi
Ato ishin dikur!
Do të zhdukej me to edhe ajo
Si efundit pjesë e së pafundmes ekzistencë-
Ajo ekzistencë e cila padrejtësisht
Të lidhur me atë vend e mbante.

### Trup

Një energji e re krejt e panjohur
Vitet I ktheu në një stuhi të zemrës,
Asnjë kujtim s'kish më rëndësi,
Asnjë fytyrë s'kish më brishtësinë e dikurshme
Dhe ato vende, njerëz e ditë
Para meje u shembën si muret e një tempulli
Të mallkuar nga perënditë!
Qëndroi në këmbë vetëm portreti yt
Sepse të dashuroja me shpirtin përgjumur.
Në këtë trup e kyçur kish qëndruar
Një dashuri që edhe kohës i ngjallte frikën
Si një stuhi e çmendur
E fshehur në një ditë korriku.
Nën lekurë diçka e madhe fjeti
Për vite me radhë…
Shenja nuk dha të energjisë
Që do të çlironte…
Nuk mund të kuptohet ajo çka
Trupi fsheh,
Askush nuk e kupton,
Deri në çastin kur është tepër vonë…

P
POEZI

*Cikël i këndshëm i sjellë nga autori për "Milosao". Me një frymë shumë lirike, por edhe me një ndjenjë të përkorë, ai sjell një gjendje të mirë poetike tek ky numër…*

# PJERGULLA NË KUPË

*- SA MË LEHTË TA SHKELIM KËTË DHÉ,*
*AQ MË PAK DO TË RËNDOJË MBI NE.-*
*'18*

NGA DEMIR GJERGJI



## 40 VJET

Ajo pa në ëndërr veten e pas 40 vjetëve dhe qeshi me lot.
Ai pa në foto veten e para 40 vjetëve dhe qau me lot.
Lotët; të kthjellët, të njelmët, të ngrohtë!

## PRESPA

-Iu gjet një poeti të vrarë "në tentativë arratisjeje".-
Prespë me ujdhesë në mes,
Andej vesë, këtej dënesë!
Natë e zezë leh steresë...
Pres pa shpresë një bukurezë,
Përmbi dallgë një xixë të ndezë.
Prespë, ujanë e pabesë,
Prerë me tre kufij tri pjesë...
Vijnë ëndrra, mjegull, shpezë,
Shkojnë shira pa kujtesë...
Ja të dal matanë, ja vdes!

## ARSYE

Arsye!
Më flak ndër yje,
Nga Qendra e Tokës,
Matanë kohës.
Arsye!
Më lidh si nyje,
Për bosht të Botës,
Me fill të aortës.
Më grind me qenien,
Më tremb me vdekjen,
Arsye!

## TI, PAS 100 VJETËSH

Gjithë ajo udhë...
Dhe farëra lulesh, që ngrihen në shtjellë,
Dhe flatrat e bardha të borës për qiell,
Dhe akuarelet e përlotur të reve pastaj,
Dhe flakët e gjelbra të pyjeve në pllajë,
Dhe flurudha fazanësh, dhe fërfërima fluturash,
Dhe psherëtima shirash, dhe prehje tej fushash,
Dhe mbërritje të përgjumura mbrëmjesh e ujërash,
Flijohen tunelit të kujtesës pa ngjarje,
Për ninëzën e syrit Tënd, që ende pret në dalje.

## PAS FLUTURIMIT

Zogu fle, i mundur nga nata,
Me kryet fshehur thellë, nën flatra,
Të mos i ikin ëndrrat e kaltra.
TE NËNA
Përsëri,
Te guri gri
Ndez qiri,
Jo për dritë,
Rit
E shpirt.
Një qiri,-
Yllësi
Në Gjithësi.

## VALSI I FUNDIT

Lundër kundër thundrës së shkumës
Në valsin e mbramë mbi valë.
E lirë si gjethja në frymë të furtunës,
Pa busull, timon, pa yll polar...
S'ka brigje për të, s'ka mbërritje,
spirancë.
Fundi në fundin e detit e pret...
Dalldiset mbi dallgë, përhumbet në vals,
Pa pyetur për nesër, për busull e breg.

## VALBONA

-Çnderimi i lumit-
Të virgjër,
Me fjongon e vet e lidhën...
Nga mesi i territ i thirrën:
-Shtrigë,
Lëri orgjitë
Me trill
E prill!
Dritë
Në pritë
Pill!

## PA SYTË

Ja tek je,
Flakëz fryme që fik shandanë,
Si atëherë, matanë,
Kur sytë e mi s'të panë!
Ja tek jam,
I sapolindur në çastin e mbramë...
Po sytë e tu...
Oh, sytë e tu, ku janë?!

***
Nën të njëjtin diell,
Shuhem në terr,
Digjesh në dritë!

## ...DHE PASTAJ...

Hë për hë,
S'je asgjë...
Mbase nesër do të shfaqesh
Avull nëpër frymë të algave,
Brerore bore përmbi male,
Flatër ëndrre pas mesnate,
Pikël-zë në strehëz jave.
Dhe pastaj,
Veç kësaj,
Kur të kthehesh në mungesë që të dhemb,
Edhe helm, edhe melhem,
Unë s'di se ç'do të jem,
Nëpër asgjësimin tënd!

## GJYSMËFLUTURIM

2006* shpendë i futën të gjallë në dheun e lagësht!
Një flatër,
Vetëm një flatër
Përplasej furishëm mbi varrin makabër...
E dinte veten në qiell të kaltër
Dhe shoqen thërriste,
Të dilte prej baltës.

---

**) Numri përkon me Vitin e H5N1 në Shqipëri.*

## MBËRRITE ME MBRËMJEN

Në sekondën e fundit të ditës së parë të vjeshtës,
Erdhe të më sjellësh
Atë që s'ma sollën gjithë vitet e jetës.

## GJENDJE GJUMI

1.
Më shtroi nëna të flija,
Fjeta, siç flenë fëmija.
2.
Më shtroi bija të flija,
Fjeta si vetë Perëndia.
3.
Ti më shtr(i)ove të flija,
Fjeta sa fle dashuria.
4.
Më vuri Zoti të flija,
Fjeta sa rron Gjithësia.

5 ËNDRRAT E 1001 NETËVE
Pëllumb në gjumë
Si zog e zunë,
Përfund e vunë
Me mund e dhunë.
Pas gjurmësh, gjithkah,
Te ëndrrat që pa,
Në jetën kaba,
Veç frika s'iu nda.
ËNDRRA I:
*-Ati-*
Hapin e vogël, çapin e lehtë,
Këmbë e rëndë egër e ndjek.
Inati, xhelati dhe Ati,
Fantazma në të bardha,
S'i ndahen nga prapa.
Poshtë në bosh, i ngrati,
Lart, në breg, i(n)ati.
Asnjë strehë a ndihmë...
Në zgjim gjen shpëtim.
**Refren:**
1001 net,
Kjo ëndërr e ndjek!
ËNDRRA II:
*-Burgu-*
Përtej kufijsh, në tjetër dhè,
I mundur, më në fund po fle.
Me tmerr sheh veten përsëri,
Në mëmëdheun-burg të tij.
Si me konop, në fëmijëri,
Shtrënguar egër me kufij.
Nga ëndrra del, i lumtur sheh
Vetveten prapë në njerkë-dhè.
**Refren:**
1001 net,
Kjo ëndërr e ndjek!
ËNDRRA III:
*-Fundi-*
Në majë të natës,
Në fund të gjumit,
Me frikë prej majës,
Me tmerr prej fundit.

**Refren:**
1001 net,
Kjo ëndërr e ndjek!
Ëndrra IV:
*-Qentë-*
Lehin qentë e mprehin dhëmbët,
Nga pas i vijnë këmba-këmbës.
Prej frikës ëndrra e braktis,
Plagët lë në shpirt e mish.
**Refren:**
1001 net,
Kjo ëndërr e ndjek!
Ëndrra V:
*-Orbitat-*
Në hapësirë, në gjumë të thellë,
Orbitat ndjek me tmerr në qiell:
Në tjetër udhë shkon hënë e vonë,
Dielli del nga perëndon.
Kiameti ende po vonon!
**Refren:**
1001 net,
Kjo ëndërr e ndjek!
**Finale:**
1001 netët ikën...
Frika s'e njeh më frikën!
Dhe dita zbardh,
Në Gjumë të Madh!
LARG FËMIJËRISË
Fara e shkundur në dheun e mirë,
Ka dhjetëra vjet që fle e mpirë...
Ende s'ka mbirë.
Gracka që ngreha atëherë, atë verë,
U shkel nga drerë, skifterë e korrierë,
S'u shkreh asnjëherë.
Kokrrat që lidhën motit ullinjtë,
Përcollën dasmorë, pritën stuhinë...
Ende degëve nxijnë.
Udhës së ëndrrës u nisa të vij.
Rashë në grackën, që ngrita fëmijë,
U shpova nga gjembi i farës së mbirë,
Më zgjoi një thinjë,
Nën drurët e blertë, në brinjë.
FANTAZI PËR SELFIE
Në klimë të ligë,
Një shpirt fisnik,
Banon me frikë
Në trup armik.
Pusia, që ngriti për vete, e ndali.
Arma, që zemrës ia shkrepi, s'e fali.
Në trupin e huaj, plumbi
U ftoh e udhën e humbi.
Në klimë të ligë,
Një shpirt u fik...
Po shkon mbi vig.

## MË MËSO!

Më mëso ta dëgjoj zërin tim nga buzët e tua,
Që ta dish, ta besosh, se ç'përmbys te burri një grua.

## VEPËR ARTI

Ideja ishte e rrënjës:
Të ikte, të arratisej nga sytë këmbët
Prej trungut...
Dhe kështu do të nisë akti i krijimit të bukur:
Degët pa lejlekët do t'i thajë etja,
Gjethet që do mbeten, hijshëm do të zverdhen.
Lëkura, gravura-gravura,
Mbi trungun, ku befas do shfaqet skulptura
Skalitur me dalta zhuzhakësh e thneglash,
Mes shirash, thatësirash, blerimesh e erërash.
Do të vijë çasti, do të ndrijë fati,
Për drurin e ngratë, tashmë vepër arti:
Në mes të sallonit që pret vizitorë,
Mes luksit, nën blice, nën sy e projektorë,
Do të ngrihet lart, i thatë, jetëgjatë ky dru madhështor!
AH, TI!
As kyç, as pranga s'të kam vënë,
As urdhër, që të jesh e imja,
Por lidhur je, në degë e rrënjë,
Me fatin tim, ndodhitë e mia.
Të tjera hije të mbulojnë,
Në tjetër shtrat bën gjumë e zgjohesh,
Po ndërsa mbjell një dorëzonjë,
Sheh larg, mos shfaqem horizontesh.
Me sytë nga udha, gjoksin mbush,
Me gjithë erërat, që të fryjnë
E mendjen s'ta kthen dot askush,
Që s'është në to e imja frymë.



Frymëmarrja ime psherëtin.
Sakaq ti nis ta kthesh në fjalë:
"I miri im! Mëkati im!
Sëmbimi im... Ti, mall e djall!"
Të tjera mbrëmje, vijnë të fshehin,
Të tjera buzë të japin puthje,
Tek natën shtyn e pret mëngjesin,
Pas lotit, vështron udhën tutje...
KORBAT MBI PRIZREN
Hapet goja e mbrëmjes për gjumë.
Nga shekujt e shkuar si shkrumb
Korbat ngrihen tufë mbi turmë...
Pëllumba të butë gjithkund.
Pa nisje, pa mbërritje, pa zhurmë e pa gjurmë,
Me kokën tënde të bukur mbi gjunjë,
Rroj çastin fatlumë.

## VARRIMI I BEKIM FEMIUT

- Një prizrenas: "Para vetëvrasjes, e pat lënë me fjalë, që trupin e pajetë t'ia digjnin e hirin ta hidhnin në Lumbardh."-
Sa herë në varr pat hyrë e dalë
Dhe prapë, i gjallë ndër të gjallë!
Mbi valë ia mban Lumbardhi hirin
E rrjedh drejt detesh, t'ia gjejë shpirtin.
HAMLET!
-Status i Ofelisë në facebook-
Fshehur fjalëve frymë dhamë,
Shfaqur syve ters u ndamë,
Dy fatzinj në famë e flamë,
Unë, mesnatë e ti, fantazmë.

## FATOS ARAPIT

Vdekja dhemb në jetë,
Mjaft rënkove: Oh!
Ngujohu i qetë,
Në arkëmortin kohë!
*Ditëvdekje, 11 e vjeshtës II, 2018*

## LEXIM BIBLE

Mbi dyllin e tyre qirinjtë,
Më këmbë ndriçojnë për meshë,
Të ngrenë krye nuk dinë,
Mbi dorën që erdhi t'i ndezë.
Ashtu ndaj vdekjes njeriu.
Nuk bëri kurrë protestë,
Ku flaka e fatit i priu,
Shtegtoi në mort e në festë.

## TRINI E PANDRYSHUESHME ME FINALE

Uji, po ai,
I paranjeriut,
Ndonëse njeriu,
E piu,
E ngriu,
E shkriu,
E nxiu.

Zjarri, po ai,
Si në gjenezë,
Para rrufesë,
Ndonëse u ndez,
Nga brezi në brez,
Si gjëmë e zezë,
A si mëngjes.

Guri, po ai,
I parajetës,
Ndonëse jeta,
E gdhendi
E trembi,
E shembi
Nga vendi.

Dhe Ti, po a-jo...
As po, as jo,
Ndonëse të ngjalla,
Te fjala
Të shpalla,
Në mall të kalla
Si në përralla.

## CIKËL I MBYLLUR

Im bir,
E këputi frutin e mëkatit,
Që s'munda ta arrij.
Ime bijë,
Sheh poshtë
Të sajën foshnjë.
Më rrallë së larti,
Nga i ati.
Paskëtaj,
As majë,
As maj,
As skaj.
Atlas vëllai,
Lërma Globin, ta mbaj!

## URDHËRORE

Hesht e mos u duk,
Të të ndjej si ujk!
KUFIRI
Në ikjen tënde nis dëshira,
Siç koha lind, ku vdes hapësira.

## ROJA

Plaçkë të vjedhur më vunë të ruaj,
Shpërblimin ma zhvatën hajnat e huaj!

## SHAMPANJË

Ishin të gjitha për festën:
Parfumet, kostumet, tangot e tangat...
Shampanjës s'ia ndjenim mungesën.
(Kujt iu kujtua shampanja?!)
Atë çast më pe edhe qeshe,
Salla si shishe shampanje u shkund...
Ç'më duhej më shumë,
Se ajo shkumë,
Atë të shtunë?!
BARKA NË BREG
-Sërish për Ty-
Pas gurëve të zinj e lidhur me cimë
Si i dehuri penguar për hije të vet,
Në ankth e në tmerr i lutet për ndihmë,
Hapësirës detare, ku fati e pret.

## LUNDËRTARI

Një jetë në det.
Vonë,
Në fundin e vet,
Ia njohu rreziqet.
Tërhiqet,
Kur s'i duhen më brigjet.

## LETËRSI BURGU

Vijnë zbathur virgjëreshat,
Udha ikën si kometë.
Fusha hapet, hapet, hapet
Tej në det.
Krejt si bimët, shkrim i imët,
Nëpër fletë.
Bëje frymën fjalë, poet,
Çliroje qelinë e shkretë!

## HIJA E MURIT

Mëngjeseve
Shkon lirishtave,
Ngjitet brigjeve,
Shkel rrezeve,
Ndalet në sytë e saj të zinj,
Andej.
Mbrëmjeve
Prangë lidhet,
Gjymtyrëve të tij,
Këndej.
Muri,
Gur pas guri,
Shpuar shpirtrash,
Tejetej!

## ARRATI

Tabutë, frenat dhe rreshtat,
Nenet, kodet dhe teshat,
Prangat, morali, proverbat,
Skemat, skenat dhe skedat,
Vulat, urdhrat dhe shenjat,
Masat, madje edhe rrenat,
Oraret... Të tjerat si të tjerat,
Bashkojnë fuqitë e verbra,
Të t'i shkopsitin sumbullat e sermëta,
Të t'i thyejnë burgjet e erëta!

## GJETHJA

1.
Gjuhëz e gjelbër puhize,
Nga bisk i mështeknës në pllajë!
I thirre dimrit të shkrijë,
I fole vjollcës të mbijë,
E ftove qyqen të vijë,
Pa ditur asgjë për stuhinë,
Që do të të flakë një ditë...
Mbi rrezet lidhe një linjë,
Mes meje dhe yllit të Saj.
2.
Gjethe e thatë vetmie,
Trishtimit të vjeshtës jetime,
Nën hapa të lumtura bie
E shkelesh pa dashje, pa faj,
Ndërsa mështekna në pllajë,
Sheh ëndrra të tjera me maj.

A
ARGUMENT

*Kompozitori i njohur shkodran Zef Çoba dhe bashkëpunëtorët e tij po korrin rezultatin e punës së palodhur të përbashkët të një grupi muzikor të mrekullueshëm brenda një shoqate muzikore. Qyteti, që shpesh është temë e lënies në harresë, ka treguar se përmes artit të këtij grupi është përcjellë në kalendarë muzikore prestigjiozë dhe më shumë akoma i ka ruajtur dimensionin e madh kulturor qytetit. Pa përmendur profesionalizmin e madh dhe CV-në shumë të nderuar të z. Çoba, shoqata "ROZAFA EXPRESSION" organizon për çdo vit aktivitete, mes tyre si Festa "VIVA LA MUSICA", por edhe merr pjesë në shfaqje prestigjioze ngado....*

# Kur e bukura e resht të hidhurën

NGA BEN ANDONI

Kur shiu i një dite prilli u mundua t'ua bëjë sfidën e pamundur, koristët shkodranë të një formacioni "modest", nuk e mallkuan qiellin, që u prishi atë mjedis të bukur krijuar me grupin sivëlla holandez. As nuk ankuan. Askujt nuk i treguan gishtin. U futën në sallën e provave dhe sëbashku me ta dhe spektatorët e pranishëm mbaruan "Lule Borën" e famshme, nën një zë të përbashkët me drejtimin e Zef Çobës, përshtatur profesionalisht për korin e dy grupeve në Shkodër. Këtë gjë kishte bërë dirigjenti i njohur edhe pak më parë me "Ave Marinë" (Javier Busto : 1949) e kështu me radhë.

...

Kjo ngjarje e këtij viti mund të jetë e panjohur për rrethet kinse elitare të muzikës, por jo për shpirtin e vërtetë të artistëve që performojnë dhe ndajnë mes tyre vlera artistike. Ndaj, ndodh që kompozitori Zef Çoba nuk bën shumë zhurmë apo të rrahi gjoksin që qytetit të vet i ka ndryshuar disi kahun *monoton* me iniciativën e vet. Thjesht, i ka marrë emrin e simbolit ose më qartë i ka kapur një qasje dhe atë ia ka blatuar një grupi simpatik, që më vite është rritur dhe po ndërton një histori të bukur. Në fakt, shoqata Miqtë e Muzikës "Rozafa Expression", e cila filloi si një shkundje për gjendjen e pashpresë në Shkodër dhe harresën e artistëve tashmë është kthyer në sfidë për jetën artistike jo vetëm të qytetit. Po ndaj kujt vallë? Menefregizmit, monotonisë dhe humbjes së vlerave të qytetit të tij dhe ngado në vend. Mbase edhe vetë profesor Çobës në vitin 1999, kur e krijoi grupin, nuk i ka shkuar mëndja se potenciali human vokal mund të arrinte të thyejë gjendjen apatike, si ajo që e mban Shkodrën të ngërthyer prej dekadash. Pa shërim.

"Rozafa Ekspression", sot, thjesht dhe pa bujë, krijon shfaqje, bën kontakte, hap gjeografinë e shfaqjeve dhe mësyn në sfida profesionale. Ajo që nisi si një angazhim modest tashmë është kthyer në një shfaqje profesionalizmi, ku këngëtarë e muzikantë të kualifikuar përshfaqin aktin më të lartë të përfaqësimit të tyre, si një ***detyrim qytetar*** e ***artistik*** të anëtarëve. Kjo e fundit e lidhur me realitetet artistike të ndërtuara mbi ekspresivitetin e vlerave muzikore, shprehet krijuesi i saj Çoba.

Siç ndodh në vendin tonë, ku vëmendja kapërthehet në gjërat sipërfaqësore, "Rozafa Ekspression" nuk shikohet ashtu si duhet pasi performon kudo *free* në vendin tonë, në vende që shumë refuzojnë t'u dëgjojnë dhe emrin e jo thjesht repertor shumë elitar me një përfaqësim profesionist të spikatur, por edhe arrijnë e përcjellin mesazhe të larta sociale të paqësisë dhe bashkëjetesës. E kurdo, pa zhurmë, por me angazhimin e madh për të kapur majat e nivelit artistik.

Shoqata, tashmë, ka ngritur një strukturë që tregon mëtimet e mëdha: Ajo mbart plot katër seksione: Korin e të rriturve ***"Rozafa Expression",*** grupin vokal ***"Loja e notave muzikore",*** për formimin muzikor të fëmijëve dhe të rinjve, seksionin ***"Në lulishten e këngës shkodrane"*** për edukimin e këngëtarëve të rinj dhe seksionin ***"Miqtë e Muzikës".***

Fryma e grupit duket se mbahet nga tradita jashtëzakonisht e madhe e qytetit, që organizatori i saj e ka të vendosur në themel të ekzistencës së grupit. Nga ana tjetër, në këtë grup kemi dhe përfutjen e vlerave më të thella që janë krijuar pas viteve '90.

Por edhe njëherë duam të theksojmë sesa më i fortë të jetë tharmi artistik dhe përthithja dhe bashkësia e vlerave, aq më i fortë është edhe fryma e grupit. Ky është ai elementi, që këtë grup të këndshëm prestigjioz sot e ka bërë të ngrejë shumë reputacion dhe mbi të gjitha të përfaqësojë vendin në aktivitete të ndryshme, ku parametrat artistikë janë në të njëjtin nivel me rëndesën e aktiviteteve.

Në këtë frymë, repertori këtij grupi mbart shumë këngë tradicionale Shqiptare, përpunime, por edhe vepra të zgjedhura nga muzika korale e stileve, epokave dhe vendeve të ndryshme.

Për t'u përmendur, mund të konsiderohet edhe një nga arritjet e këtij formacioni. Qysh nga 21 qershori i vitit 2007 në ***Ditën Ndërkombëtare të Muzikës***, shoqata "ROZAFA EXPRESSION" organizon Festën **"VIVA LA MUSICA"**. Dhe, arritja e këtij grupi është se ka krijuar një traditë dhe zhvillohet çdo vit në formën e një Koncerti jo vetëm me pjesëmarrjen e solistëve, korit, grupit vokal të fëmijëve "LOJA E NOTAVE MUZIKORE". Në fakt, kjo është e pamjaftë pa paraqitur edhe elementë të tjerë të njohur, që lidhen me kontributin e shfaqjeve të lira për grupe të ndryshme shoqërore dhe mjediset shumë sociale që janë krijuar, duke bërë atë që muzika di të bëjë më mirë: paqtimin dhe ngritjen e shpirtit në lartësi të bukura. Dhe, në një botë ku e keqja pothuaj ka pushtetin, muzika dhe interpretimi i këtij grupi bëjnë luftën e tyre për ta mposhtur...Pa bujë. Modestisht. Bukur. Dhe, me shumë profesionalizëm.



Kori i të rinjve Oldenzaal & Kori "Rozafa Expression" (para shfaqjes)



## Për grupin

Kryetar i shoqatës është dirigjenti dhe kompozitori i njohur prof. Zef Çoba, i cili ka një kontribut të çmuar në jetën artistike e muzikore. Ai ka kompozuar vepra e pjesë të ndryshme vokale e instrumentale, muzikën e 16 filmave artistikë, muzikë për teatër, këngë në stil të traditës qytetare shkodrane, për fëmijë etj., shumë prej të cilave kanë fituar popullaritet absolut. Një cikël me romanca vokale të titulluar "Kënga e njeriut"; ciklin me këngë korale për fëmijë "E drejta dhe e shtrembra", përpunime, etj. Është pedagog pranë Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve Tiranë në lëndët Dirigjim Koral, Këndim Koral dhe Muzikë dhome, dirigjent i Korit të Kishës së Shën Françeskut-Gjuhadol (Shkodër).




Kori i të rinjve Oldenzaal & Kori "Rozafa Expression" ("Ave Maria")

Shoqata, e në veçanti kori i të rriturve, ka organizuar shumë aktivitete e ka marrë pjesë me sukses në Festivale Ndërkombëtare të koreve brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilët veçojmë: në **Shqipëri** (Tiranë 2000, Shkodra Jazz 2007, Tiranë 2009); **Greqi** (Andros 2000, Karditsa 2000, 2013), **Mali i zi** (Cetinje 2000, Tuz 2007, Tuz 2018 Ulqin 2016); **Itali** (Avola -2000, Vibo Valentia- 2001, Ripatransone-2007, Svigliano, Cuneo, Saluzo 2009, Assisi 2014); **Maqedoni**(Tetovë 2007, Tetovë 2009, Tetovë 2011, Tetovë 2013, Tetovë 2014, Tetovë 2015, Tetovë 2016, Tetovë 2017), Shkup(2018); **Serbi**(Kragujevac 2011, Negotin 2018); **Kosove** (Gjakove 2014, Gjakove 2015, Gjakove 2017); Austri(Graz 2017); turne koncertesh në **qendra të ndryshme të Napolit**(Itali 2007). Premiera e koncerte në qytetet e Shkodres, Tiranës, Durrësit, Korçës, si dhe mjaft shfaqje e koncerte festive përvjetoresh, në Shkolla, Azile, Shtëpi fëmijësh, Spital, Burg etj.

Eksperienca e Shoqatës Miqtë e Muzikës "Rozafa Expression" ka shërbyer edhe për dirigjentët e rinj studentë të Universitetit te Arteve Tiranë, të cilët kanë mbrojtur diplomën me koncerte të përgatitura nga Kori.

Falë bashkëpunimit me Shoqatën "AUSTRIA – ALBANIA PARTNERSCHAFT MARIANNE GRAF + TEAM", Shoqata "ROZAFA EXPRESSION" ka "QENDREN E KENDIMIT KORAL" me Sallën e aktiviteteve dhe Koncerteve, mjediset e punës përgatitore etj.

Realizimi me sukses i aktivitetit të Shoqatës "Miqtë e muzikës Rozafa Expression", është bërë i mundur falë punës humane dhe të palodhur e me pasion të anëtarëve të shoqatës, kontributit të tyre si dhe kontributit të çmuar të donatorëve, sponsorëve e dashamirësve të saj, mbështetja e të cilëve ka qenë dhe është një inkurajim i madh, në të mirë të gjallërimit e konsolidimit të jetës kulturore e artistike në vend, si dhe dialogut ndërmjet kulturave e popujve të ndryshëm.

Opinioni i Ditës

# Tritoli i fjalëve

Nga Sulejman Mato

*(vijon nga faqja 1)*



... hedhjen në erë të një shtylle tensioni. Dhe kjo sillet si një fakt se ja, KESH-i nuk ecën si duhet, pasi me tritol në gojë e nxit kundërshtarin për terrorizëm.

Me votat tona kemi krijuar një parlament, i cili ka humbur kuptimin, pse është zgjedhur dhe çfarë duhet të bëjë. Çfarë bën sot parlamenti ynë? Çdo të ënjte bën një luftë të ndezur fjalësh. Është një parlament i tipit "Albanistan". Gjatë viteve tridhjetë, kur në Europë dominonin dy diktatorë të mëdhenj, Hitleri dhe Stalini, sipas filozofit G. Sartori, "as njëri dhe as tjetri nuk kanë pretenduar kurrë që regjimet e tyre të ishin demokratike". Në ato vite, sipas Sartorit, nuk kishte debate, ndonëse duhet thënë që të dy këta diktatorë, përfshi dhe Musolinin, e nisën rrugën drejt pushtetit diktatorial si anëtarë të partive të tyre socialiste. Stalini e nisi rrugën e tij drejt diktaturës duke qenë anëtar i një partie komuniste, një parti ekstremisht e majtë. Shtetet e tjera të Europës, gjer në vitin 1945, me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore ishin të kënaqura me "demokracinë" e tyre. Fjalët "demokraci" dhe "demokraci popullore" u shfaqën pas fitores ndaj nazizmit.

"Pa mbaruar përleshja e armatosur, nisi lufta e fjalëve", - thotë A.Sartori. Është kjo luftë e ftohtë fjalëve që vazhdon edhe sot në parlament, në media dhe midis formacioneve të kundërta politike.

Në këtë pikë janë të ngjashëm si dy pika uji, socialistë dhe demokratë... Njëra forcë nxin, forca tjetër zbardh. Njëra forcë akuzon, tjetra shpif dhe shantazhon. Kjo quhet lufta e ftohtë e fjalëve. Filozofi Karl Poper thotë: "S'kemi pse të zihemi për fjalët dhe për ca pseudo probleme të tilla si kuptimi i vërtetë, thelbësor i fjalës demokraci. Secili mund të zgjedhë emrin që dëshiron".

Sigurisht që në parlamentin tonë, por edhe në debatet publike nuk zihen për fjalët, as për platformat e tyre të përafërta, grinden me fjalët dhe për fjalët. Lufta e fjalëve ka rëndësinë e vet, mirëpo kur largohesh nga thelbi, debati kthehet në një banalitet të plotë: "Kush ishit ju e kush jemi ne", "Kush jemi ne e kush ishit ju", "Sa vodhët ju e sa vodhëm ne"...

Materialistet dhe pragmatistët i përdorin fjalët në kuptim materialist, që nënkupton se çfarë mund të përfitohet nga kjo luftë fjalësh. Idealistëve të Partisë Socialiste, si dikur Blushi e tre-katër të tjerë, ose i vetmi, i dikurshëm, Blushi, u mbetet ta përdorin fjalën si artin e lashtë të bindjes, për të parë poshtë, në popull, realitetin e hidhur.

Edhe pse fjalët shprehin mendime dhe emocione, ato nuk duhen marrë seriozisht, kur lufta behët vetëm në kuadrin e fjalëve. I humbur në luftën e fjalëve është vetëm ai që nuk e njeh artin e oratorisë. Padyshim, edhe kur fjalët nuk përçojnë ide dhe fakte, ato lënë gjurmët te kundërshtari, por edhe te populli i thjeshtë, i cili nuk e ka intelektualitetin e oratorëve për të shtrembëruar të vërtetën. "Populli përbëhet nga mendje të thjeshta", -thotë G.Sartori, te libri "Edhe një herë për teorinë e demokracisë". Populli i thjeshtë priret të besojë dhe ka të drejtë të besojë ato çfarë thonë oratorët e politikës. Populli di vetëm një gjë, që jeton në një sistem demokratik dhe që sipas rrotacionit të qeverisjes, qeveriset nga socialistët dhe jo nga demokratët. Ai nuk e ka të qartë se ku është ndryshimi midis kuptimit të fjalëve "socialist" dhe "demokrat". Ata janë ndarë midis tyre në këtë luftë fjalësh, ashtu siç ndahen tifozët në një ndeshje futbolli, dikujt i pëlqen fanella e kuqe, dikujt i pëlqen ngjyra blu. Preferenca, padyshim nuk është kaq e thjeshtë. Ka edhe arsye të tjera, si për shembull, për shkaqe mentaliteti apo të trashëgimnisë familjare. Në fakt, preferencat duhet të ishin sociale, për shkak të platformave ekonomike. Mirëpo, platformat e tyre janë gati të njëjta, madje duket sikur Partia Demokratike në luftën e saj për pushtet, ofron më tepër një reformë ekonomike më të majtë se e majta. Ku është ndryshimi? Kam idenë se këtë gjë nuk e dinë as vetë oratorët, pasi fjalët "demokraci" dhe "socializëm" përmbajnë në vetvete kuptime konvencionale.

"Pa mbaruar përleshja e armatosur, nisi lufta e fjalëve", - thotë A.Sartori. Është kjo luftë e ftohtë fjalëve që vazhdon edhe sot në parlament, në media dhe midis formacioneve të kundërta politike.

Materialistet dhe pragmatistët i përdorin fjalët në kuptim materialist, që nënkupton se çfarë mund të përfitohet nga kjo luftë fjalësh. Idealistëve të Partisë Socialiste, si dikur Blushi e tre-katër të tjerë, ose i vetmi, i dikurshëm, Blushi, u mbetet ta përdorin fjalën si artin e lashtë të bindjes, për të parë poshtë, në popull, realitetin e hidhur.

Në fjalorin politik ka shumë fjalë që shprehin në vetvete konvencione. Fjalët fashizëm, nazizëm janë pjellë e partive socialiste në vendet e tyre, të cilat tashmë kanë hyrë në fondin e fjalëve pegiorative. Po kështu, edhe fjalët "ballist" dhe "zogist", për arsye që nuk dua të zgjatem me këtë histori, kanë hyrë në këtë fond pegiorativ. Në fondin e fjalëve pegiorative ka hyrë pjesërisht dhe vetë periudha e socializmit, ku u ndërtua shteti dhe u zhvillua shoqëria. Pra, është fare e thjeshtë të etiketosh me fjalë një njeri, një shoqëri, një sistem qeverisje. Qeverisje popullore e kemi quajtur kohën e socializmit, qeverisje popullore e quajmë qeverisjen që kemi sot. Ku qëndron ndryshimi? "Demokracia lidhet me socializmin, - thotë Tokëvili, vetëm nëpërmjet një fjale-barazi, por duhet pasur parasysh dallimi: Demokracia është barazi me liri, kurse socializmi kërkon barazi me varfëri dhe skllavëri".

Socializmi sot është një socializëm liberal-demokratik, ku një nga cilësitë e tij është që individit t'i jepet e drejta të mbrohet me avokat. "Ku qëndron ndryshimi midis një avokati dhe një hajduti?", - më pyeti një ditë një avokat, si me shaka. Dhe më pas u përgjigj. "Ndryshojmë shumë. Ne jemi hajdutë me licencë".

"Lufta e fjalëve thotë Ch.Stevenson ka të bëjë me vlerat e tyre emotive". Poeti sovjetik, Evtushenko kur erdhi në Shqipëri dhe u takua me disa shkrimtarë dhe artistë, shoqëruesi e prezantoi si një poet disident. Jo. tha ai, duke u ngritur me vrull në këmbë. Unë nuk jam disident. Unë jam intelektual i lirë. Kritikoj dhe sot çdo padrejtësi, kur shoh që gjërat nuk shkojnë mirë. A e dini se çfarë ndodh tek ne? - vijoi ai - Tek ne është krijuar një parti, që mban emrin popullore. Ajo i ka zyrat në një kazermë ushtarake dhe vetëm emrin ka "Popullore". Ishin ato vitet e para pluraliste, ku edhe te ne mbinin partitë si kërpudhat pas shiut.

Qytetarët çdo të enjte shohin spektakël me luftë fjalësh. Një luftë e ashpër me fyerje, presione, trillime dhe shpifje djathtas-majtas. Nxij e ndrit, nxij e ndrit. Njëra palë nxin, pala tjetër ndrit. Mirëpo jashtë parlamentit, pas luftës së fjalëve, rrinë gati bodigardë, vrasësit e paguar, hajdutët e pronës shoqërore, kriminelë të lidhur me pushtetin dhe trafikantë. Lufta e ndezur e fjalëve nis në parlament dhe vazhdon në jetën e përditshme. Ajo i ka rrënjët në parlament. Ajo ka tribunarët e tij në parlament, pasi jashtë tij ka nga ata që e ushqejnë atë dhe e shumëzojnë atë luftë.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është teorik. Edhe lufta e fjalëve e çon përpara mendimin dhe progresin. Ajo që dua të theksoj në këtë shkrim është kjo: Është tepruar shumë me këtë luftë të ashpër fjalësh. Jemi lodhur me këtë parlament. Jemi lodhur me këtë spektakël luftarak. Jemi mërzitur me këtë luftë të tipit: Unë shaj, ti shan, ai shan. Lufta e fjalëve duhet të jetë e tillë që të vlerësohet fakti dhe të mospërjashtohet kundërshtari. Je i lirë të flasësh. Je i lirë të debatosh, je i lirë të thuash mendimin tënd. Je i lirë të këmbëngulësh në mendimin tënd. Por, nuk ke të drejtë dhe nuk je i lirë për t'i imponuar kundërshtarit mendimin tënd me çdo kusht. As të kërcënosh me levat e verbra që të shoqërojnë. Në qoftë se ajo që bëhet sot në parlament është një luftë e ftohtë fjalësh, pa prapavijë, ajo duhet të mbarojë me një paqe dhe shtrëngim duarsh midis dy kundërshtarëve. Lufta është luftë. E ashpër dhe e fortë, por debati duhet të jetë një debat intelektual, që do të thotë, në fund të ndeshjes kundërshtari politik duhet t'i shtrëngojë duart kundërshtarit, ashtu siç ndodh në një ndeshje boksi. Boksierët nuk janë intelektualë, por pas grushteve dhe shqelmave vjen shtrëngimi i duarve. Në fund të ndeshjes boksierët qetësohen, i japin dorën njëri-tjetrit. Në fund të ndeshjes, edhe lojtarët e lojës "lufta e fjalëve" duhet të qetësohen dhe t'i japin dorën njëri-tjetrit, në qoftë se kjo luftë fjalësh në parlament është vetëm një lojë.

Opinioni *i* Ditës

# Emrat e ministrave që do largojë Rama dhe kush qëndron në qeveri

Nga Sokol Balla

*(vijon nga faqja 1)*



... zakonisht provohet në ditë të vështira - kryeministri dukej nga portreti se ka filluar të bindet se fatin njeriu e bën vetë. Ose në rastin e tij, nuk e lë dot në duart e ministrave.

"Astiri" dhe skandali që ai hapi - aq më keq që habiti dhe amerikanët - i tregoi atij, se më fund duhet të merret seriozisht me letrat zyrtare dhe jo me vizatimet në zyrë. Çështja e Teatrit i tregoi atij se gjithkush duhet të marrë përgjegjësitë e veta dhe as ai të kreut të bashkisë dhe as kreu i bashkisë atë të ministrit të Kulturës. Rasti i studentëve dhe Kuvendi i PD i tregoi se Shqipëria nuk mund të jetë një vend aq tolerant, sa reformën e arsimit ta bëjnë sponsorët e Lulit dhe ndërkohë më pas Luli të mbështesë studentët dhe të fusë në radhët e Këshillit Kombëtar, pedagogë të Trustit të Universiteteve, që dhjenë reformën, raportet me studentët dhe me të vërtetën.

Studentët me krizën që krijuan, i treguan atij se vendi nuk qeveriset dot me meme dhe statuse në "Twitter" dhe as me fjalime maratonë si Nicolas Maduro në Telesur. Studentët, "Astiri", Shkoza, Gjushi, Lala, Sajmiri, dosjet e dukshme dhe të padukshme të gjetura nga Xhafaj, padurimi i Pandit për t'u bërë së paku sërish protagonist dhe së shumti kryeministër, shkeljet e syrit majtas e djathtas mu nën hundën e tij, mesa duket kanë bërë që kryeministri të kuptojë atë që kemi ndjerë të gjithë: që kabineti i dytë i Ramës është më i keq se ai i para zgjedhjeve të majit 2017.

Kjo u kuptua edhe në rezistencën jo të vogël të brendshme në PS ndaj zgjedhjes së një kandidature të paoksiduar për ministër, atë të Sandër Lleshajt. Vetë e kuptova pak ditë më parë kur këtë personazh i veshur varfër si një prift françeskan, por me ide të pasura se si të modernizohet policia dhe shteti, e kisha dy orë përballë në emision. Një personazh që me Edi Ramën është 99.99 për qind jo i përshtatshëm, por që e bashkon ideja sesi gjërat janë keq dhe duhen bërë më mirë. Njeriu që me sa duket, edhe para të gjithëve i ka kërkuar atij një plan kombëtar kundër kanabisit dhe që ndryshe nga Fatmir Xhafaj, siç e tha edhe vetë, mendon "që forca e ligjit duhet të ndihet çdo ditë dhe jo me fushata".

Nga e hëna prisni më shumë Sandër Lleshaj që të futen në qeveri. Rama duket se e ka ndarë mendjen që jo të gjitha vezët duhet të jenë për të. Ca t'i hajë edhe Lindita, edhe Damiani, edhe Arbeni (këtë mendon edhe partia e Erion Braçeve, një shumicë e heshtur dhe mbështetëse në kohë të vështirë dhe ankimtare, sa herë qeveria 'fluturon me pras' drejt lartësive të panjohura). Po ca vezë duhen edhe në dyert e Shëndetësisë, plot me PPP-ra dhe të pabëra, po ku ende sot vdesin foshnje në qytete periferike a thua se jetojmë në Burkina Faso dhe qeveria rezidon në Uagadugu.

Edi Rama ka kuptuar se nuk mund të presë. Ai me dinakëri ka kuptuar se nuk ka luksin e protestave me pushime brenda, siç çuditërisht përfundoi ajo e studentëve. Edi Rama e di që tani se SPAK po ngrihet dhe nuk ka më luksin të presë që fati, njohjet dhe ndërkombëtarët të mbyllin një sy ndaj atyre që ia hoqën tepsinë e bakllavasë LSI, për të ngjyer buzët dhe mëngët me sherbetin e pushtetit.

Edi Rama e di që para ligjit nuk ka përgjegjësi kolektive, por ama ka kuptuar se para popullit ka gjyq individual, si të atyre që e dhjesin si në Shkodër, Pogradec apo Elbasan. Por edhe aq mirë sa të atyre në Bashkinë e Tiranës, që mund t'i rrezikojnë kuotat e sondazheve dhe t'i personalizojnë ato, aq sa ai të jetë i pafuqishëm t'i ndalojë apo ngrijë, siç bëri në shtator 2014. Edi Rama e ka kuptuar se me ngritjen e SPAK, jo vetëm do jetë i pafuqishëm të mbrojë ministra e kryebashkiakë, por s'do ketë ndonjë ndikim të madh edhe në emrat e zëvendësuesve dhe për këtë ka ende para syve se qoftë Xhafaj, qoftë Lleshaj, erdhën, ikën dhe ikin, jo duke i marrë leje atij. Unë e kuptova këtë në intervistën me ministrin e ri të Brendshëm. Ai e do formën, si Tahiri dhe Rama. Ai nuk harron, si Fatmir Xhafaj. Por ai nuk merr urdhra si gjithë të tjerët. Ose së paku, nuk i merr vetëm nga Rama.

Ndaj të hënën, kur Edi Rama të formulojë zyrtarisht nevojën e ndryshimeve të forta në qeveri, prisni gjithnjë e më shumë "UFO" si Sandër Lleshaj të futen në qeveri.

Sepse të hënën Edi Rama nis procesin e ndryshimeve më të mëdha në një qeveri, që formalisht nuk ka rënë akoma. Një qeveri që nuk ndryshon trekëndëshin më të fortë - Mbrojtje (amerikanët), Rend (Drejtësi) - europianët, Diplomaci (ndoshta dhe Turizëm e Bujqësi), por që mesa duket do të prekë të gjitha ato sfera të jetës sociale, ekonomike dhe politike që janë menaxhuar kaq keq, që para majit 2017.

Edi Rama kërkon të krijojë shpejt dhe pa humbur kohë (deri në Asamblenë e 29 dhjetorit gjithçka mbyllet totalisht), një kabinet mbrojtës, duke rrëzuar kështu vetë i pari iluzionin e paprekshmërisë, përballë një opozite të dobët, e cila pritet shumë shpejt, edhe ajo nga SPAK dhe amerikanët, të marrë një goditje në themel dhe një tërmet që mund ta shkundë rëndë dhe për një afat të gjatë.

Kryeministri e ndjen se po vijnë kohë të këqija. Ai i njeh mirë ato, se ka bërë 8 vjet në opozitë. Dhe i duhet një kabinet me energji dhe vizion tjetër, që të përgatisë vendin për epokën e re që jo domosdoshmërisht lidhet me datën e zgjedhjeve lokale dhe as atyre të përgjithshme.

Edi Rama do të ndryshojë qeverinë këtë javë dhe do bëjë shumë mirë. Por, ai duhet edhe të qartësojë mirë se çfarë do bëjë me zgjedhjet lokale. Të zyrtarizojë kandidimin e Veliajt dhe moskandidimin e Dakos dhe Sejdinit and co? Dhe t'i japë fund dilemës amatoreske, por inefektive që është përhapur dhe që insinuon largimin e Veliajt nga drejtimi i Tiranës dhe moskandidim në 30 qershor. Unë mendoj se me frikën e këtyre ditëve dhe ndryshimet në qeveri që do t'i thotë të hënën, ai e ka pranuar këtë. Por kësaj radhe kryeministri duhet vërtetë të bindë kryeministrin të parin, se nuk është prekur nga sindroma e 'Prasit', që prek çdo mazhorancë në mandatin e dytë të saj.

Edi Rama punoi aq shumë që në fushatë vjet që të na mbushte mendjen se ky ishte mandati i tij i parë si kryeministër, saqë përfundoi ta besonte atë edhe vetë. Sinjalet janë që e ka kuptuar gabimin dhe se të hënën nis reflektimin, duke filluar nga vetja. Tek ajo pikë - pra te vetja e tij - ka qenë gjithmonë shumë i kujdesshëm. Si gjithmonë ka fat. Në kohë të vështira, defektet personale jo rrallë e kanë ndihmuar të dalë i fituar, edhe atëherë kur nuk e ka kuptuar as vetë.

## HOROSKOPI

### DASHI
Kjo ditë do të jetë shumë e volitshme për bashkëpunime në planin ekonomik. Për shumë projekte të reja do të keni përkrahjen e bashkëpunëtorëve. Do të keni mundësinë që të realizoni atë ide që prej një kohe të gjatë e keni ëndërruar.

### DEMI
Përfitimet financiare do të dyfishohen për ju, edhe pse do të shpenzoni dyfishin e tyre. Kini kujdes nga fjalët e ëmbla të një personi. Fjala është për personin, i cili dëshiron vetëm t'ju shfrytëzojë.

### BINJAKET
Lidhja juaj dashurore është duke funksionuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Personi juaj i dashur do të jetë posaçërisht i kujdesshëm ndaj jush. Por edhe ju do t'ia ktheni me të njëjtën mënyrë.

### GAFORJA
Bëjini mirë atyre që janë të gatshëm t'jua kthejnë në të njëjtën mënyrë, sepse gjatë kësaj periudhe përreth jush do të sillen shumë njerëz që janë tepër egoistë.

### LUANI
Bëni kujdes nga një person, i cili po përpiqet me çdo kusht që të jetë sa më afër jush. Sado që të keni nevojë për dashuri, nuk është mirë të kërkoni të lidheni me çdokënd, sepse do t'ju shkaktojë kokëçarje të mëdha.

### VIRGJERESHA
Kohëve të fundit jeni bërë një farë personi "i mjerë", i cili kënaqet me pak. Mos u dorëzoni, nga fundi i javës do të merrni një lajm, i cili do t'ju bëjë të jeni të lumtur.

### PESHORJA
Në punë jeni shumë i qëndrueshëm, ndaj përpiquni që kështu të jetë edhe në të ardhmen. Një projekt në të cilin jeni duke punuar, po jua shton vetëbesimin dhe po jua eliminon të gjitha vështirësitë e jetës.

### AKREPI
Disa persona të kësaj shenje ka gjasa të përfshihen në afera dashurie, aq më shume ata që planifikojnë të udhëtojnë. Sfidës dashurore nuk do t'i shmangeni dot kurrë.

### SHIGJETARI
Mjaft keni ngurruar, tani është koha që t'i hyni një sfide për të cilën prej një kohë të gjatë jeni përgatitur. E dini se pa sfida sukseset nuk arrihen, gjithashtu e dini që ka ardhur koha e duhur që të veproni.

### BRICJAPI
Në jetën sentimentale do të ketë ndryshime. Ata persona të cilët nuk janë të kënaqur me lidhjen e tyre do të arrijnë të jenë të lumtur, ndërsa ata që kanë lidhje të shkëlqyeshme do të kenë luhatje.

### UJORI
Aty ku e vëreni se do të jeni i tepërt, mos shkoni, por jini prezent aty ku e ndieni veten më të sigurt. Energjia gjithnjë e më shumë do t'ju mungojë, andaj është mirë që të pushoni më shumë.

### PESHQIT
Shkoni në atë ambient ku do të jeni më të relaksuar. Por për të pushuar, zgjidhni vetëm orët e mbrëmjes, sepse gjatë ditës duhet të kryeni detyrimet e shumta që keni. Përqendrohuni vetëm te punët më kryesore.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Janë luftarake me kung fu.
6. Eshtë me helm ajo e agjentëve.
12. Skuadra merengue.
13. Fillojnë tatëpjetën.
14. Ed aktor.
15. Një pjesë... orkestrale.
16. Një iranian i dikurshëm.
18. Janë tek në kanape.
19. I bën kush ha bukë.
22. Fundi i një fundi.
23. Fillojnë aksionin.
25. Janë zeshkanë.
26. Shumë zëra në këngë.
27. Gjysmë turneu.
29. Eshtë grykësi
31. Rastisin në krye.
32. Sikur ke thënë çdonjerin.
34. Janë vite.
36. Angot e Lecocq.
37. Ende është ndryshe.
39. Kush bën... ve në lojë.
40. Janë grimca me bërthama.
41. Turner këngëtare.
42. Të parat në bllok.
44. Diftong për leader.
45. Dhe Hajria në një balet.
47. Neill aktor.
49. Ross këngëtare.
50. Mund të jetë parabolike.

VERTIKAL
1. Janë kundërmuese.
2. Vreri pa kufij.
3. Kush nuk ka... nuk di të sillet.
4. Artikull spanjol.
5. Eshtë krimb për grep.
6. Mbyllin një krah.
7. Edouard piktor.
8. Fillojnë profesionin.
9. Turke pa kufij.
10. Ishte Gjermania e Honecker
11. Janë më shumë se dëshira.
13. Janë ujërat në llixha.
16. Bëhet me kandar.
17. I dëgjoi vetëm Odiseu.
20. Fillojnë hetimin.
21. Një qendër.
24. Eshtë vjedhje.
28. Makashi këngëtar.
30. Me Alfa në makinë.
33. Loriku te Sunderland.
34. Një pjesë e momenteve.
35. Gjysmë tatimi.
36. Janë legjenda.
38. Nget edhe ajo e mirë.
40. Myslymi i paharruar i futbollit.
42. Ki Moon i OKB.
43. Flemig që krijoi James Bond.
45. Fillojnë hapur
46. Mbyllin komentin.
47. Fillojnë sefte.
48. Fillojnë masat.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Eshtë kombëtare me minoritetin.
6. Janë godinat e banimit.
12. Van Nistelrooy bomber.
13. Eshtë e e pas Krishtit.
15. Një fjalë para kohe.
16. Organizma Tregare Lokale.
18. Rripi pa zë.
20. Flloko aktor
21. Volumi i shkurtër.
22. Eshtë diletant.
25. Kufizojnë pozicionin.
26. Eshtë X ajo e sulmit.
27. Ishin shoqëruesit e Panit.
29. Kufizojnë katete.
30. Janë çupa.
31. Bartok kompozitor.
34. Tri të parat në atletikë.
36. Tekat pa kufij.
37. Një pemë.
38. Skuadër greke.
41. I triumfit ai i Remarque.
42. Janë shokë në shoqëri.
46. Me të bëjnë një metër.
47. Fillojnë romanin.
48. Eshtë kukull kur është nën ndikimin e të huajve.
49. Kush nuk di... mbytet.
51. Një struc australian.
53. Një pjesë e tematikës.
54. Renato kantautor italian.
55. Mbyll shishen.
56. Furtado këngëtare.
57. Burton regjisor.

VERTIKAL
1. Janë shkaktarë sherri.
2. Kanë bërë vepra.
3. Eshtë shtëpi me frëngji.
4. Fillimi i ideologjisë.
5. Inicialet e Einstein.
6. Janë gazetat si RD.
7. Lodh në kufij.
8. Ishte lumi i harresës.
9. Eshtë për medaljen e parë.
10. Një fjalë që tregon ritmin.
11. Kolegj i famshëm anglez.
14. Janë pesë të tillë olimpikë.
17. Janë zengjinë.
19. Kishte 100 porta.
23. Një pjesë e masakrës.
24. Mbarojnë fare.
28. Janë toka edhe sportive.
31. Stoker që shkroi Dracula.
32. Eshtë byrek.
33. Hapur pa kufij.
35. Pal latinisht.
39. Rraqe pa re
40. Film i famshëm me Brad Pitt dhe Kevin Spacey.
43. Qyteti i përjetshëm.
44. Një jepet për hartim.
45. Jessica aktore.
50. Cruise aktor
52. Janë në kupë.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | | | | 7 | | 3 | 6 |
| | 4 | | | 2 | | | 5 | |
| 6 | | | | 5 | 4 | 8 | | |
| 7 | 6 | | | 3 | | 1 | | 5 |
| 5 | | | | | | | 6 | |
| 9 | | 2 | | | 8 | | | |
| 8 | | | | | 2 | 5 | 7 | |
| | | 1 | 4 | | | | | 8 |
| | 9 | | | | | 3 | 2 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 7 | 2 | 9 | 5 | 6 | 8 | 4 | 3 |
| 9 | 5 | 4 | 3 | 8 | 7 | 6 | 1 | 2 |
| 6 | 8 | 3 | 2 | 1 | 4 | 9 | 5 | 7 |
| 2 | 9 | 1 | 5 | 6 | 3 | 4 | 7 | 8 |
| 5 | 6 | 7 | 4 | 2 | 8 | 3 | 9 | 1 |
| 4 | 3 | 8 | 7 | 9 | 1 | 5 | 2 | 6 |
| 7 | 2 | 5 | 6 | 3 | 9 | 1 | 8 | 4 |
| 3 | 1 | 9 | 8 | 4 | 2 | 7 | 6 | 5 |
| 8 | 4 | 6 | 1 | 7 | 5 | 2 | 3 | 9 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Është e dhimbshme për ti thënë "lamtumirë" një personi që nuk do të të braktiste kurrë ... por më e dhimbshme është ti kërkosh një personi të qëndrojë duke e ditur se një ditë do të të braktisë!!!

- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendo të jetë vetëm ajo që me të vërtetë ti dëshiron!!!

- Duhet një minutë për të parë një person të veçantë, një orë për ta vlerësuar, një ditë për ta dashuruar, një fjalë për ta lënduar ... dhe një jetë për ta harruar atë !!!

## KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 14 | 2 | 7 | 4 | 3 | 9 | 7 | ■ | 7 | 19 | 3 | 6 |
| 4 | 2 | 3 | 3 | 2 | 8 | 9 | ■ | 7 | 6 | 8 | 4 | 14 |
| 9 I | 3 R | 5 M | 6 A | ■ | ■ | ■ | 17 | 1 | 8 | 9 | 6 | 2 |
| 7 | 10 | ■ | 18 | 9 | 7 | 4 | 9 | 5 | 6 | 4 | ■ | 7 |
| 6 | ■ | 5 | 4 | 3 | 3 | 2 | 12 | 9 | 4 | 2 | ■ | 20 |
| ■ | 5 | 2 | 4 | 2 | 1 | 3 | 9 | 4 | 2 | 4 | ■ | 6 |
| 3 | 1 | 5 | 6 | 8 | 4 | 9 | 7 | 2 | 4 | ■ | 12 | 8 |
| 2 | 8 | 2 | ■ | 15 | 6 | 4 | ■ | 4 | ■ | 7 | 1 | 15 |
| 16 | 9 | 16 | ■ | 2 | 14 | 6 | ■ | 9 | ■ | 1 | 8 | 2 |
| 2 | 4 | 2 | 3 | ■ | 1 | 14 | 6 | ■ | ■ | 12 | 6 | 3 |
| 4 | 1 | ■ | 2 | 6 | ■ | ■ | 17 | 6 | 4 | 6 | 14 | ■ |
| 6 | 3 | 7 | 9 | 18 | 6 | 4 | ■ | 15 | 6 | 7 | 2 | 4 |

## KRIPTOSKEME
*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D | R | I | T | A | R | E | T | ■ | B | O | T | E |
| O | ■ | R | A | P | ■ | F | ■ | B | E | L | A | T |
| B | I | ■ | K | O | L | O | N | E | L | ■ | B | I |
| I | ■ | F | I | T | O | R | E | T | ■ | T | E | K |
| ■ | K | O | M | E | N | T | E | T | ■ | E | L | E |
| H | A | R | E | M | ■ | E | R | E | ■ | R | A | T |
| T | A | M | T | A | M | ■ | A | ■ | S | R | ■ | A |
| ■ | S | A | ■ | ■ | E | D | ■ | S | T | I | ■ | ■ |
| D | ■ | T | E | K | S | T | ■ | M | I | T | E | T |
| E | H | ■ | R | R | I | ■ | K | I | L | O | N | I |
| M | I | R | I | A | M | ■ | K | R | E | R | E | T |
| I | T | A | ■ | P | I | N | ■ | A | T | I | ■ | O |

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

### FJALEKRYQI (1)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P | E | T | E | R | ■ | ■ | ■ | P | A | M | O | R | E |
| A | M | E | N | ■ | K | ■ | B | A | N | O | R | E | T |
| ■ | R | ■ | A | M | I | T | A | ■ | E | D | E | M | A |
| P | I | E | ■ | A | N | A | T | E | M | A | T | ■ | T |
| R | ■ | T | E | L | E | P | A | T | I | ■ | ■ | T | ■ |
| E | K | O | N | O | M | I | K | E | ■ | ■ | R | E | S |
| K | E | N | E | T | A | T | ■ | R | O | B | E | R | T |
| E | M | ■ | R | ■ | ■ | E | H | ■ | R | O | M | B | I |
| S | I | N | G | E | R | ■ | I | N | A | T | ■ | I | N |
| ■ | S | A | J | D | I | T | E | ■ | R | I | T | M | O |
| S | H | ■ | I | ■ | N | E | N | ■ | E | M | ■ | I | R |
| D | A | M | A | R | I | ■ | A | K | T | E | T | ■ | E |

### FJALEKRYQI (2)

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | P | O | T | ■ | P | ■ | B | A | ■ | A | L | F | A |
| A | S | ■ | O | P | E | R | E | T | A | T | ■ | A | S |
| U | ■ | O | P | E | R | A | T | ■ | D | O | ■ | R | A |
| L | I | P | ■ | L | I | P | O | T | I | M | I | A | ■ |
| ■ | M | O | N | O | T | O | N | I | ■ | I | R | O | N |
| L | I | Z | ■ | T | O | R | ■ | T | L | ■ | O | N | ■ |
| A | T | I | ■ | A | N | T | E | U | ■ | E | N | I | ■ |
| D | I | T | A | ■ | I | I | ■ | L | U | M | I | ■ | S |
| A | M | A | N | E | T | ■ | A | L | G | A | T | ■ | F |
| ■ | E | ■ | I | R | I | S | ■ | A | ■ | R | E | N | E |
| S | T | O | L | I | ■ | K | U | R | A | T | ■ | A | R |
| P | ■ | M | A | K | E | T | ■ | E | L | E | H | T | E |

## Thënie të mençura

- Heshtja është si ngjyra e ujit që nuk e shihni, por është i nevojshëm !!!

- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoj më... vetëm mos harro se dikur isha atje për ty ... dhe ti nuk dite të më vlerësosh !!!

- Gjërat më të bukura në jetë nuk i shohim me sy ... por i ndjejmë me zemër !!!

- Kur interesohesh, nuk harron... kur kujdesesh, nuk i kthen shpinën mbrapa, kur do...nuk kërkon kohë ... kur dashuron nuk lëndon!!!


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al